

# LAJMËTARI

I BERATIT

**Kryeredaktor:**  
Agim Mehqemeja  
**Reportere:**  
Eriola Azizolli  
**Dizajn:**  
Anxhela Bibo.  
**Menazhimi:**  
Yzedin Hima  
**Botues:**  
Lajmëtari sh.p.k.

Viti I, Nr.14 E përjavshme e pavarur

E mërkurë, 8 tetor 2003

Çmimi 20 lekë

Adresa: Lagjja "Dëshmorët e Kombit", pranë shtypshkronjës "Lirsan Ekspres". Tel: + 069 2586803

## Javën tjetër, një qeveri e re lokale

Eriola Azizolli

### "Mjaft" bashkon në debat kandidatët e Beratit

Faqe 2

Yzedin Hima

### Adhurimi i së bukurës dhe e bukura e traumatizuar

Faqe 3

Një shkrim dhe një Intervistë me publicistin Simon Vrusho

### Intelektualë apo militantualë?

Faqe 4

STRES

### Në shkollat e Beratit mungojnë regjistrat

Faqe 5

### Bashkia e qytetit shpërndan tituj nderi për personalitete të spikatura

Faqe 7

Vasillaq Kumani

### Të vdekurit kërkojnë pensionin e pleqërisë

Tregim humoristik

Faqe 8

Agim Mehqemeja

### Historiku i bibliotekave të Beratit

Faqe 9

Arjan Soraj

### Mjedisi shqiptar është edhe mjedis evropian

Faqe 10



### PS dhe PD mbyll fushatën elektorale me dy mitingje në qendër të Beratit

Në datën 7, në orë 16.00, Partia Socialiste organizoi në qendër të Beratit një miting përmblyës të fushatës elektorale. Kreu i saj shpalosi programin e Partisë Socialiste dhe i kërkoi elektoratit të votonte për kandidatin e saj, z. Fadil Nasufi. Nuk munguan as akuzat për kandidatët e tjerë të opozitës ose dhe të kandidatëve të pavarur.

Sot më datë 8 në orën 11. 00, do të organizojë një miting përmblyës për fushatë elektorale edhe Partia Demokratike nën siglën "Ejani me ne". Me siguri kreu i PD-së në miting do të mbrojë alternativën e vet dhe do të ftojë qytetarë beratas të votojnë për kandidatin e saj z. Mehmet Xheka. I takon qytetarëve beratas që në datën 12 tetor ta zgjidhin dilemën me votën e tyre.

Qytetarët shqiptarë kanë edhe tri ditë refktimi. Pas tri ditësh ata do të votojnë. Do të ushtrojnë një nga të drejtat e tyre, atë të votës së lirë. Do të kenë rastin të reagojnë si të gjithë qytetarët e lirë të botës, për përmirësimin e jetës në komunitetin e tyre.

Është një rast fatlum për qytetarin e thjeshtë. Ky rast nuk përsëritet çdo ditë, por njëherë në tre vjet. Në datë 12 tetor, pushteti është në duart e lodhura të njerëzve, të cilët e fitojnë jetën me mund e mend.

Në 12 tetor shfuqizohen arroganca e pushtetit, arbitrariteti, klani, paaftësia e ngritur në pushtet. Kompozohet një tjetër qeverisje lokale. Me synimin për t'u bërë më e mirë, më racionale, më njerëzore, më e përgjegjshme. Me synimin për të shërbyer, jo për të sunduar. Në sytë dhe veshët e votuesve janë emrat e kandidatëve, listat e këshilltarëve. Ata do të mendohen mirë gjatë tri ditëve dhe të dielën do të kenë vendosur se kujt do t'ia besojnë Çelësin e madh të qytetit për tri vitet e ardhshme.

Herë-herë thuhet se qytetarët kanë shansin të marrin pjesë në qeverisjen lokale në një vend të lirë. Është e vërtetë që e kanë shansin, por forcën për të zgjedhur një qeverisje normale e kanë vetëm një herë në tre vjet. Ndaj atë pasuri të madhe, votën gjithkush le ta depozitojë sipas dëshirës, por duke menduar gjatë për vete, për fëmijët e tij, për komunitetin. Më 12 tetor flet populli. "Populli po", siç shkruan Karl Sundburg.

Y. Hima

## Si mund të mbroni automjetet tuaja?

### Përdorni vajra të cilësisë së lartë

TEXACO



Goma të ndryshme

KËTU DO TË GJENI:



Shell

ALDOM



FILTRA



Bateri të cilësisë së lartë

Tek Parku i Urës Vajgurore  
Adresa: Përballë Western Union

Pronari: Edison Fitim Beshiri  
Tel: 0682235888

## “Mjaft” bashkon në debat kandidatët e Beratit

LËVIZJA “MJAFT”, e organizuar kohët e fundit, për t'i thënë mjaft apatisë qytetare, dhunës ndaj gruas, krimin, ka organizuar një debat midis kandidatëve për bashkinë e këtij qyteti. Me moton “këtu vendos unë”, lëvizja “MJAFT” ka zhvilluar një koncert në qendër të qytetit mesditën e ditës së enjte, ndërsa më pas aktiviteti ka vijuar me debatin e kandidatëve. Në sallën e TV Onufri, pranë ish-shtëpisë së ushtarakëve, janë mbledhur për të shpalosur alternativat e tyre pesë nga kandidatët e këtij qyteti për kreun e bashkisë. Përballë sallës së mbushur me qytetarë, të rinj e të reja, pjesëmarrës të lëvizjes “MJAFT”, kanë dalë kandidatët: Fadil Nasufi i PS-së, Mehmet Xheka i PD-së,



Kandidatët për kryetarë bashkie në debatin televiziv

Nexhmedin Musai i PDR-së, Avdyl Pilafi dhe Dashnor Luka kandidatë të pavarur. Drejtuesi i këtij debati, një nga anëtarët e kësaj lëvizjeje, i dha nga tetë minuta kohë çdo kandidati për të shpalosur alternativat e veta. Kandidati i PS-së Nasufi, i pari që paraqiti disa nga projektet e tij qeverisëse, u

shpreh se e niste konkurimin për të vazhduar punët e nisura në mandatin e kreu të bashkisë Mata, mbështetur nga PS. Ai premtoi përmirësimin e situatës energjitike, përmirësimin e furnizimit me ujë të qytetit, mbylljen e ciklit të rrugëve me rikonstrukcion, qytet të pastër, lagje të sistemuara dhe programe për

rininë. Ndërsa, kandidati i PD-së Xheka u shpreh se do të bëjë të pamundurën për të zhvilluar ekonominë e qytetit me anë të tërheqjes së biznesit, rifreskim të profilit të qytetit, ndërtimin e planit rregullues të qytetit, etj. Në fjalën e tij për programin kandidati Pilafi u shpreh se do të bëjë të pamundurën që t'i kthejë qytetit muzeun historik e vlerat e tij të humbura gjatë viteve të fundit. Ndërsa kandidati tjetër i pavarur Luka u shpreh se do të moderizoj qytetin kudo. Kandidati i PDR-së Musai, ndryshe nga kandidatët e tjerë, u shpreh se do të bëjë shumë, përfshirë dhe premtimet e tyre. Më pas pesë kandidatët iu përgjigjën pyetjeve të sallës.

Eriola Azizolli

## Një pyetje kandidatit të PD-së Dr: Mehmet Xheka

Në takimin me banorët e lagjes “Muzaka”, një nga pjesëmarrësit iu drejtua me një pyetje kandidatit të Partisë Demokratike Dr. Mehmet Xheka:



Kandidati i PD-së Dr. Mehmet Xheka

“Berati ka ujë e në rubinetat e qytetarëve rrjedh pak ujë, vetëm dy herë nga një orë në ditë. Ç’premtion kandidatit për ta zgjidhur këtë problem?”

Kandidati në përgjigjen e tij theksoi se problemi i ujit për Beratit është plotësisht i zgjidhshëm. Kjo është kryesisht në dorë të pushtetit vendor. Zgjidhja, sigurisht, varet nëse do të kem votën e qytetarëve të mi. Ndërmarrja e ujës jellës ligjërisht është në vartësi të bashkisë dhe i takon këtij institucioni ta zgjidhë këtë problem, të mbyllë të gjitha plagët që ka ujës jellësi gjatë rrjedhës së tij. Kjo do të arrihet duke vënë para përgjegjësisë ligjore të gjithë ata që kanë bërë ndërhyrje të paligjshme. Problemi i furnizimit me ujë të pijshëm të fshatrave, është detyrë e pushtetit qendror. Nuk duhet të rëndojë mbi banorët e qytetit të Beratit. Edhe nëse do të kemi pengesë nga pushteti qendror, do të kapërcehet me fitoren e së djathës në zgjedhjet për pushtetin qendror dhe me financimet për ujës jellës të rinj për të gjithë fshatrave që nuk kanë ujë të pijshëm.”

Agim Mehqemeja

## Qyteti i Beratit meriton një qeverisje më të mirë

Kandidati i pavarur Luka paraqet programin elektoral përpara gazetarëve

KANDIDATI i pavarur për kryetar bashkie Dashnor Luka, ka dalë disa ditë më parë përpara gazetarëve ku ka paraqitur përpara tyre programin e tij elektoral. “Modernizimi i administratës publike, -u shpreh Luka, është pika kryesore e programit tim elektoral. Unë premtoj transparencë për koston dhe shërbimet në administratë, konsolidim të buxhetit, shpenzime me efektivitet, motivim të punonjësve të bashkisë. Nën drejtimin tim bashkia do të ketë hapje kombëtare të qytetit me anë të binjakëzimeve, futjen e kalasë së Beratit në shoqatën

Botërore të Kështjellave, mbështetjen e biznesit beratas, ndërtimin e një qendre kombëtare e ndërkombëtare panairësh. Një nga pikat e rëndësishme të programit tim do të jetë dhe programi social, krijimi i një qendre tregtare, legalizimi i ndërtimeve, ulja e nivelit të papunësisë, punësimi i vajzave dhe djemve, rritja reale e asistencës, garantimi i shërbimeve imobilare për të pastrehët. Po kështu, në programin tim elektoral një vend të rëndësishëm do të zërë dhe zhvillimi i sportit dhe kulturës me krijimin e qendrave sportive, ujore,

vënia në efikasë e poligonit të qitjes, rehabilitimi i fushës së vjetër të sportit, binjakëzimi i shkollave të qytetit me shkolla gjermane. Ndërsa, në programin urban do të jetë rehabilitimi i rrugëve dhe trotuareve, ndërtimi i unazës së re të qytetit, rehabilitimi i kolektorëve, emërtimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, institucioneve”.

Më pas kandidati Luka iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve. I pyetur nga gazeta “Lajmëtari” se përse shfaqet pikërisht tani në jetën politike, kandidati Luka u shpreh se, ndonëse jam larguar nga vendlindja për të



Kandidati i pavarur Dashnor Luka

punuar, herë pas here jam kthyer në qytetin tim, pasi jam i lidhur ngushtë me të dhe tani vij për t'i shërbyer bashkëqytetarëve mi.

Eriola Azizolli

## MEDIAKAFE...

Një fshatar i rrëzës së Shpiragut po i ankohej një fshatari të një zone tjetër se mbi fshatin e tij nuk mbante mend të kishte kaluar ndonjë zog. Dhe jo vetëm mbi fshatin e tij, por në krejt rrëzën e Shpiragut.

- Të paktën të fluturonte një skifter!- qahej shpiragasi.

- As që ka për të fluturuar ndonjëherë!- i foli me siguri tjetri. Sa për arsyen, po ta shpjegoj tani. Një komshia im ka një kopsht të bukur dhe qershiat e tij i pëlqejnë të gjithë, por ia mbaruan zogjtë. Nuk la gjë pa provuar. Ndërtoi lloj-lloj dordolecësh por... hiç.

Një ditë, i mërzhitur, nxorri nga sënduku fotografinë e komandantit legjendar dhe po e pastronte nga pluhuri në dritën e diellit. Që atë çast dy harabelë u ulën mbi sofat dhe lëshuan dy kokrrat e qershive të sapovjedhura. Komshia e vendosi fotografinë e komandantit të pavdekshëm në trung të lisit dhe nuk pipëtin më krahë zogu, jo më në kopshtin e tij, por as në fshat. Tani besoj, e kupton pse nuk fluturon as skifteri mbi fshatin tënd.

Nëse jo, hidhi një sy malit e vështro.

\*\*\*

Përfaqësuesi i një ambasade të një vendi të BE-së ndaloi në Berat javën e kaluar dhe në tavolinën e shtruar po bisedonte me zyrtarët e lartë të qytetit për problemet e integritetit të Shqipërisë në Europë. I bëri përshtypje njëri prej tyre që fliste e fliste pa pushim e me mjaft admirim për Europën dhe për vendin mik që përfaqësonte i huaji, të cilin e kishte vizituar nja 30 herë gjatë tre viteve mandat. Përkthyesi nuk pati mundësi të pinte as edhe një gllënkë birre, sepse qe i detyruar të përkthente ligjiratën e gjatë të zyrtarit të lartë. Të huajit i pëlqeu sidomos qartësia me të cilën i trajtonte problemet e integriteteve zyrtari lokal.

- Zotëria pa dyshim ka qënë një disident i regjimit të kaluar, qoftë edhe në heshtje, - pyeti përkthyesin diplomati.

Përkthyesi buzëqeshi disi me zor dhe shtoi: -Ndoshta, po thellë- thellë te vetja. Se, në fakt për një kohë të gjatë ka qënë sekretar i komitetit të Partisë së Punës, deri sa erdhi ky i uruar pluralizëm.

\*\*\*

Mësuesi i rreptë i gjimnazit po i fliste me ton një nxënësi që vinte në klasë pa libra: -Për çfarë dreqin vjen në shkollë? As libra as fletore?!

Nxënësi nuk iu përgjigj. Të nesërmen kishin sërish mësim me të njëjtin mësues. Mësuesi hyri në klasë me një fletore, të cilën e përdorte si regjistër. Nga që në klasë nuk kishte asnjë karrigë, qëndroi para tabelës së zezë. Hapi ngadalë fletoren dhe nisi të bënte apelin.

Kur shqiptoi emrin e nxënësit pa asnjë libër, mësuesi tha:

- Edhe sot me duar në xhepa ke ardhur?

- Sot jemi të barabartë, profesor. Edhe unë e kam marrë fletoren.

Nga xhepi nxorri një fletore të ngjashme me atë të mësuesit, me një qen bulldog të përgjumur në kopertinë.

Gent Panariti

# Adhurimi i së bukurës dhe e bukura e traumatizuar

Yzedin Hima



KUR individi shqiptar u ndje i lirë, domethënë shpëtoi nga puna e detyruar në ferma, fabrika primitive, tarraca e aksione, ku punonte falas për ndërtimin e ferrit kolektiv, pa rreth e rrotull tij se mos gjente punën e tij të re. Kuptohet, nuk ishte e lehtë. Tani e tutje secili do të punonte për vete. Në atë mjerim total, ky fakt ishte mjaft grishës. Individi shqiptar në përgjithësi nuk pa mundësitë që egzistonin në vendin e tij, ndaj u derdh drejt Perëndimit me të gjitha mjetet, me çdo çmim. Tragjedia e shqiptarëve në malet e Jugut, në malet e Lindjes dhe sidomos tragjedia në Adriatik e Jon do të jetë një mallkim që do të ndjekë gjatë politikën shqiptare të shekullit që lamë pas e të këtij fillimshkulli.

Ndërsa një pjesë e shqiptarëve, duke parë rreth e rrotull, nga të gjitha resurset e këtij vendi si punimi i tokës, mbjellja e vreshtave, kopshtaria, mekanika, peshkimi, ndërtimi, dalloj më të brishtë, më delikaten, atë që në fakt bën një kontrast të thellë me vrazhdësinë e jetës së këtushme, me terrenin, me psikologjinë e krijuar në shekuj, femrën. Delikatesa, bukuria, brishtësia u kthyen për një pjesë jo të vogël të femrave shqiptare në fatkeqësi. Nisi shfrytëzimi barbar i tyre nëpër rrugët e Perëndimit. Endrra, sidoqoftë, qe e bukur: Do iknin larg këtij vendi të ashpër, ku butësia, delikatesa, bukuria ose nuk viheshin gjithmonë re, ose shiheshin si një peizazh mahnitës, ku mund të vije për piknik kur të doje dhe pas të lije ambalazhet e një dite të grisur, hequr nga shitshim me bukurinë e ashtu, pa kujdes. Endërrimeve dhe shenjtërimin që për një botë, ku bukuria ishte te poeti i njohur disident butësia të mos qenë e shprehur në femrën dhe gruas në kontrast i thellë, një lëkër e vlefshme kunadhejeje. Në të njëjtën kohë, si guaska perlën, dy shënjestra gjahtarësh shqiptarë: Endërronin një botë të kishin mundësi të punonin ndoshta edhe shumë, për të merrnin një pagë të denjë për të cilën të jetonin si njerëz të

A mund të gjykohej njeriu pse ëndërron? A mund të dënohet njeriu pse mendon bukur për jetën e vet? Herë-herë varfëria dhe mjedisi i mjeruar përreth ishte i tillë në familjet shqiptare, sa që vajzat kanë pranuar ta ndërrojnë atë me çdo çmim, qoftë edhe me humbjen e lirisë, trajtimin kriminal dhe daljen te sheshi "Loreto" në Milano, i njohur sot si vendi ku u var Musolini dhe sheshi ku varen çdo ditë prostitutat shqiptare për t'u zgjedhur nga pleqtë maniakë.

Atë shenjtërim të femrës e quanim si një magji thjesht artistike, ose shprehje e një bote të largët, matanë yjeve që nuk kishte asnjë lidhje me mjedisin tonë. Liriku ynë i famshëm Lasgush Poradeci, poeti i vibrimeve qiellore të shpirtit njerëzor, nuk shkroi asnjë poezi gjatë socrealizmit të diktaturës. Një poezi e përkthyer nga gjermanishtja prej poetit në këtë kohë, një poezi jashtë shijes artistike të tij, është domethënëse dhe e efektshme për kohën kur u

evropiani i sotëm është krijimi i së bukurës dhe përjetimi intensiv i saj. Në fakt, mesazhin e parë të të jetuarit estetik, e ka dhënë gjeniu anglez, Shekspiri. Ai krijoi figurën e famshme të Hamletit që u përpoq të jetonte estetikisht në mug të qytetërimit, në një botë që gëlonte nga e keqja dhe krimi. Këndvështrimi estetik i botës nga Hamleti ( etja për pushtet, tradhëtitë, pabesitë ,vrasjet para së gjithash për Princin e famshëm qenë të shëmtuara), qe revolta dhe tragjedia e tij. Dhe Evropa u bë duke menduar bukur, duke punuar bukur.

Përfytyroni njeriun e dëshpëruar shqiptar tek sillet në këtë mjedis. Po nga erdhi një mendësi e tillë në shoqërinë shqiptare? Natyrisht ky mentalitet u krijua gjatë shekujve. Vetëm mungesa e lirisë krijon deformime të tilla të genit. Mungesa e gjatë e institucioneve, e gjuhës së shkruar, e librave, e letërsisë, e artit, e filozofisë, e besimit krijoi gropa në mentalitetin tonë.

Kur vë re kujdesin prekës me të cilin trajtohet një femër në Perëndim, adhurimin për të bukurën, dallon hendekun tronditës që ndan Shqipërinë me botën e qytetëruar. Atëherë kupton shenjtërinë me të cilën e vesh femrën poezia e madhe, kupton se sa e paemancipuar është shoqëria jonë, kupton se nuk ka emancipim të gruas (kujtoni marrëzinë e dikurshme të luftës për emancipimin e gruas), në një shoqëri të paemancipuar. Kupton se ky truall nuk mund të bëhet pjesë e Evropës, derisa gruaja të konsiderohet si malli më fitimprurës nga një pjesë e shqiptarëve dhe pjesa tjetër ose nuk reagon, ose regon mjaft dobët, kur shteti fle, ose edhe bëhet pjesë e së keqes. Kupton se ne jetojmë në një shoqëri të dhunshme, ku e bukura dhe delikatja nuk mund të egzistojnë normalisht, por në forma traumatike, kur adhurimi për të bukurën, të brishtën konsiderohet si dobësi.



Pikaso: Vajzat e Avinjonit (fragment)

Kalimi nga zhveshja e femrës shqiptare nga çdo lloj feminiteti, gjatë viteve të diktaturës (përfytyroni femrën e turneve të treta, kominoshet, aksionet, zborët) në ekstremin :“ gjithçka është mall në këtë vend dhe mund të shitet dhe të blihet”, rezultoi traumatik për femrën shqiptare, respektivisht për shoqërinë shqiptare. Në vitet e shkollës së mesme më ra në dorë një poezi e Eugjen Jevtushenkos për gruan. E lexonim fshehur dhe shprehim me bukurinë e ashtu, pa kujdes. Endërrimeve dhe shenjtërimin që për një botë, ku bukuria ishte te poeti i njohur disident butësia të mos qenë e shprehur në femrën dhe gruas në kontrast i thellë, një lëkër e vlefshme kunadhejeje. Në të njëjtën kohë, si guaska perlën, dy shënjestra gjahtarësh shqiptarë: Endërronin një botë të kishin mundësi të punonin ndoshta edhe shumë, për të merrnin një pagë të denjë për të cilën të jetonin si njerëz të

A mund të gjendet një lakuriqtë gruaje të mbështetësh kokën e mendjehhtë.

përkthye:

**E rëndësishme është në këtë botë do ta them, ti mos u ngut, të rrish në bisht në nevojtoare lart yjet e poshtë mut.**

Është i shpjegueshëm trajtimi i ashpër i femrës në Shqipërinë e diktaturës, brenda trajtimit të të gjitha vlerave në një diktaturë, por është i pafalshëm trajtimi i femrës shqiptare në postdiktaturë. Goditja e figurës së saj është goditje që i jepet shoqërisë shqiptare. Trajtimi kriminal i vajzave në trotualet e Evropës, i dha imazhit të shqiptarit formën e përbindëshit dhe një status aspak të lakmueshëm për shqiptarin normal.

Evropa ka kohë që jeton e përpiqet të jetojë estetikisht. Në themel të punës tek

## Një kërkesë për kryetarin e ri të bashkisë

**PROBLEMET** e qytetarëve janë të shumta, të shumta janë edhe kërkesat e tyre. Vetëm për një çështje dua t'i drejtohem kryetarit të ri të bashkisë, nëse do të ketë mundësi t'i përgjigjet me përgjegjësi jo vetëm morale, por edhe ligjore:

Qytetari lidh kontrata me disa ndërmarrje shtetërore për detyrime të ndërsjellta. Kontrata të tilla lidhen me KESH-in, me Ujësjellësin, me Telekomin.

Në këto kontrata nënvizohet detyrimi i çdo qytetari që t'i përgjigjet në kohë detyrimit financiar. Për ata që e shkelin afatin, qytetari i nënshtrimit kamatëvonesave. Po në këto kontrata nënvizohet edhe detyrimi i ndërmarrjeve për t'iu përgjigjur plotësisht të detyrimeve ndaj qytetarëve, siç janë plotësimi me energji elektrike dhe ujë për 24 orë rresht si dhe shërbim telefonik pa ndërprerje.

Në rastet e mosrespektimit të këtyre detyrimeve, ashtu si qytetarët që paguajnë kamatëvonesën, duhet edhe institucionet e mësipërme t'u përgjigjen atyre me dëmshpërblim.

Dhe kjo është mëse e ligjshme. Ndërpreja e dritave, qytetarin apo biznesmenin e dëmton ekonomikisht, por vetëm te ne nuk ndodh që për këto humbje, institucionet të përgjigjen. Kurse qytetari po. Nëse shteti nuk arrin t'i kompensojë dot qytetarët ose biznesmenët e dëmtuar, pse nuk ua ul taksat, apo çmimin e dritave apo të ujit, por i ngre ato? Do të thoni se ka edhe shumë qytetarë që nuk paguajnë, që kanë vite që nuk i përgjigjen këtyre detyrimeve, prandaj edhe KESH-i apo edhe Ujësjellësi e kufizojnë furnizimin. Po pse duhet të dënohen ata që paguajnë?... Nuk është dobësia e shtetit që nuk arrin t'i mbledh detyrimet? Apo lepurit fle gjatë? Lidhet me interesa të tjera?

Pak kohë më parë morëm vesh për një fushatë që ndërmori pushteti vendor në Berat për ndërprerjet e lidhjeve të paligjshme në ujësjellësin e Bogovës. Qytetarët u gëzuan, se më në fund forca e ligjit do të ndihej dhe qyteti më në fund do të kishte ujë. Por edhe kjo përpjekje dështoi. Shteti u gënjëzua. Po kështu nisi prerja e linjave elektrike në Tiranë për ata qytetarë ose subjekte që ishin borxhllinj ndaj shtetit. Po, për çudi, pa kaluar as dy-tri ditë, kjo përpjekje u ndërpre. Lidhjet u ribënë.

Mos, në të dy rastet, kjo është e lidhur me rrezikun e humbjes në këto zgjedhje vendore? Sigurisht kjo duhet të jetë.



Populi ka një thënie proverbiale: "Atë që të bën qeveria, nuk ta bënë as Perëndia".

Po kur qeveria nuk do? Atëherë duhet zgjedhur ai pushtetar që mund ta bëjë këtë. Po cili nga kandidatët do t'u dalë për zot këtyre problemeve?

Duhet menduar. Duhet përzgjedhur. Ka edhe nga ata që mund ta bëjnë punën me drejtësi dhe me përkushtim. Dhe kjo përzgjedhje mund të bëhet vetëm me forcën e votës. Nëse qytetarët mendojnë për veten e tyre, duhet të dalin të gjithë në votime dhe votën t'ia japin atij kandidati që e meriton dhe që partia që ai përfaqëson, e ka forcën ta bëjë atë që pushteti aktual nuk mundi ta bëjë.

Agron Feriti

Intervistë me publicistin Simon Vrusho

## “Kur përmenda figurën e derrit, filluan hungërimat” Intelektualë apo militantualë?



Simon Vrusho

Në mesjavën e kaluar, në mesditë, më datën 2 tetor, ditën e enjte, juve jua kanë ndërprerë diskutimin në mes në një takim me intelektualët e qytetit, të inicuar nga kryetari i PS në Berat dhe, njëherësh, kandidat për kryetar bashkie, z. Fadil Nasufi. Si e gjykoni atë akt dhe motivin që e shkaktoi?

Të jesh i ftuar nominalisht në një bashkëbisedim të lirë, për të shkëmbyer ide, mendime, sugjerime, për t'u përfshirë në një debat të argumentuar, nën këndin “Për një Berat ndryshe” do të thotë, minimalisht, duhet të kesh aftësinë për të dëgjuar si dhe hapësirën për t'u shprehur në një mjedis mirëkuptimi, tolerance dhe respekti të

ndërsjelltë. Kjo është premisë-bazë, ky është kusht paraprak në rangun e një aksiome. *Ftesën e z.Nasufi e prita me kënaqësi, pa asnjë paragjykim apo synim për incident a provokim.* Mendoja se auditori, si edhe pjesëmarrësit nuk do të ishin shumë, por ai, nga bashkëbisedim u shndërrua në takim, duke shkarë nga



Takimi i intelektualëve, Simon Vrusho

*niveli intelektual në nivel elektoral e banal. Situata kundërshtuese ndaj fjalës sime erdhi jo nga intelektualët në sallë, por nga militantualët. Për fat të keq militantualët e dominonin sallën jo vetëm me praninë fizike, por edhe me praninë zanore, hungërore, me zallamahi e karshillëk*

*qesharak.* Më keqkuptuan totalisht, më keqkuptuan ata që nuk kuptojnë dhe ata që nuk duan të kuptojnë. Madje hakërrimet e ndërkryera indirekt i drejtoheshin edhe z.Nasufi, i cili u vu në pozitë të vështirë, megjithëse ndërhyri me takt, por pa dobi. *Skena të tilla kanë qenë të rëndomta rreth një shekulli më parë në mbledhjet e*



*taborreve të Haxhi Qamilit. Si nisi kjo zhaurimë, kur ju u dëgjuat deri në gjysmën e diskutimit?*

Në diskutimin tim, për ta bërë disi tërheqës, unë përdorja edhe disa epitete të thjeshta, ndonjë figurë letrare që e gjallëronte idenë dhe

argumentin rreth saj. Madje, nga Xhorxh Oruelli i famshëm kisha marrë hua figurën e derrit. Por, pikërisht tek fjala “DERR” filluan hungërimat. Pavarësisht se e pakënd-shme, por ishte vërtet një situatë e rrallë, e cila ka brenda tharmin e një tregimi grotesk. Është mirë që atje ku nuk njihet edhe epiteti i varfër, i thjeshtë, të mos flasësh fare. E kuptoni ç'do të thotë të veshësh në raste të tilla dorashkën e metaforës? Me ç'kam dëgjuar, personi që u ngrit si monumenti i sallës, ka një mbiemër fantazmagorik.

**Ju aluduat për një emër dhe, në përgjigje të kërkesës së sallës, ju e shqiptuat emrin konkret, i cili ndodhej në sallë. Pse?**

Nuk ishte fare qëllimi im që në diskutim të zbrisja në këtë nivel. Shembulli u suall, sepse ishte perfekt për të ilustruar idenë time se deri ku të çon papërgjeshmëria në nivele të tilla drejtimi apo përfaqësimi në këshillin bashkiak. Ajo që ka ndodhur në Këshillin e

Bashkisë së Beratit në korrik të vitit 1999, nga një anëtar këshilli ndaj dhe përballë z.Hans Peter

politikanët midis tyre, se politika bëhet për popullin dhe jo për t'u përdorur si mashë për qëllime



Takimi i intelektualëve, Jashar Buba

Furrer, drejtor Politik i Këshillit të Evropës, gjatë një vizite në Berat e takimi në bashki është, për ta thënë butë, një mungesë serioziteti e pafalshme, një tregues degradimi, shembull tipik për t'u ngjitur në institucione e forume pushtetore thjesht për interesa të vockëla private, shembull i pashembullit për ta parë politikën si gallatë e barsaletë. Kjo është konstatuar nga të huajt me kohë, madje z. Furrer u shpreh në Berat: “Politika nuk është lojë për të luajtur

personale”. Mjerisht, asgjë nuk ka ndryshuar. Dua të kujtoj edhe shprehjen tjetër të tij se “Përsa kohë mbretëron korrupsioni, nuk ka për të pasur demokraci”.

Dhe unë jam thellësisht i bindur e kryesisht i qartë se sallën me 200 veta e dominonte, të paktën nga ana vokale, një masë jo e vogël militantuale. Në prerje të tilla nuk ka progres. Me njerëz të tillë Shqipëria vërtet ndryshon, por ndryshon për keq e për drej.

Lajmëtari

## Një shembull i pashembullt, një shembull-ambasador, një skandal i vërtetë

*Nga diskutimi i Simon Vrushos gjysmë i lexuar, gjysmë i ndaluar, në takimin me intelektualët e qytetit, organizuar nga Fadil Nasufi, më 2.10. 2003 në pallatin e kulturës “Margarita Tutulani”*

Zoti Fadil,

Faleminderit për ftesën, që e mora me kënaqësi e që më ngacmoi të shpreh një opinion, një mendim e, duke ardhur pa ngarkesë partie, do të shprehem thjesht si mësues dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj për vizionin tim, të ndryshëm nga i juaji. Tema e këtij bashkëbisedimi, “Për një Berat ndryshe”, për shkëmbim idesh e mendimesh për menazhimin e vlerave intelektuale dhe qytetare, është çështje themelore, është sfida e rëndë që duhet përballuar, pa mëdyshje, në rrugën e integritimit me Perëndimin.

Në vështrimin tim, gjendja e sotme, gjendje që ngërthen 13 vjet, është një fiasko e plotë, një butafori e veshur me kapadaillëk, snobizëm, injorancë, pra, një performancë që më keq nuk ka se si bëhet dhe më poshtë nuk ka se ku të bjerë. Sa për ilustrim, do të sjell vetëm një shembull të pashembullt, një shembull-strumbullar, një shembull-ambasador, një skandal i vërtetë, ku njëri, një njeri, ndër drejtuesit kryesorë të institucioneve kulturore në qytetin e Beratit e, njëherësh, deputet i parlamentit lokal dhe, njëherësh, edhe ndër drejtuesit e një partie që pretendon apo ka mazhorancën, pra, ky njeri, në një takim zyrtar e të protokolluar me shefin politik të Këshillit të Evropës, takim zyrtar me Këshillin e Bashkisë Berat, e provokon atë, shefin politik të Këshillit të Evropës, ku duam të integrohemi, një provokim halabak, banal, injorant, duke pasur guximin e marrë që sy më sy të sajojë e të bëjë të pabërën ndaj autoritetit në fjalë. Ishte një sjellje fyese për



Takimi i intelektualëve, Shpëtim Dyrmishi

Drejtorin Politik të Këshillit të Evropës, dërsa gagaçi ynë, pas ndërhyrjes me takt e politesë të vizitorit, ngaqë nuk i eci gracka banale, prapë qëndronte si kokoroç. Megjithëse nuk i eci atë radhë, nuk kishte si t'i ecte, do t'i ecte, sipas tij, radhën tjetër. Dhe atij i ka ecur e i ecën në Berat, por në Evropë, kjo injorancë e ngrirë në xhel e në klane, nuk ka derë ferme që e pret, asnjë derë ku rriten derrat nuk hapet për të! Pra ky episod është prizmi kuptimplotë që zbërthen shumë elemente se si drejton konkretisht ky pseudodrejtues. Nuk i kam mendime spontane këto që do të them, por i kam të shkruara e shprehin bindjen time.

(Këtu fillon zallamahia e sallës, zhurma, zëra, britma dhe diskutanti largohet nga podiumi, por ulet në vendin e tij në sallë).

Vazhdimi i diskutimit, pjesa e ndaluar (diskutanti ua tha se të plotë do ta shikoni në gazetë:

Ky është koncepti sundimi e abuzimi në kulturë, është diktat, që për vetë kulturën është i papranueshëm. Kjo që thashë është vërtet e hidhur, e turpshme, por e vërtetë. Episode të tilla janë emblema reale e imazhit të shpërdoruar beratas para pasqyrës normale, qoftë kjo qytetare këtu, qoftë evropiane atje. Këto foto fyese janë riprodhuar në seri gjatë, për gjatë 13 vjetëve në Berat. Kërkohe vizion i ndryshëm, koncept i kohës që na detyron rruga ku ecim e kjo kërkon vullnet për të gjetur e mbështetur njerëz të kësaj prerjeje që sjell ndryshim e jo nga këta që përshfaqin snobizëm, injorancë dhe korrupsion.

**Ju keni një post kyç, zoti Fadil, ju e keni atë post kyç dhe, ndërkohë kandidoni për kyçin tjetër, më sakt, kryekyçin e qytetit, kryebashkiakun.**

Mjerisht, në prononcimet tuaja, të shtabit tuaj nuk shoh ndonjë shenjë, nuk ndiej ndonjë sinjal, nuk dalloj asnjë siluetë, konturet e së cilës do të mund të konkretizoheshin, në rast se ju mund të fitoni. Është e dhimbshme ta konstatosh këtë te një forcë e madhe. Mungesat janë të thella në anën tuaj.

**Ju duhet ta kuptoni nevojën për ndryshim, një ndryshim joiluziv.**

**Ju edhe mund ta vazhdoni kështu edhe shumë vjet, sepse keni shumë numra, por nuk keni të drejtë. Ndryshimin, edhe po të doni, nuk e bëni dot, sepse i keni lidhur vetes, përbrenda edhe gojën, edhe duart, edhe këmbët.**

Kërkoj edhe njëherë mirëkuptimin për sa thashë, pranoh debatin dhe, ndonëse kam mendime të ndryshme nga ju për këtë temë, përsëri, për ju z.Fadil si njeri, që ju njoh prej 20 vjetësh, ruaj respekt e konsideratë të pandryshuar. Faleminderit!

Simon Vrusho

## Në shkollat e Beratit mungojnë regjistrat

Po kalon muaji dhe ende mësuesit e Beratit nuk i kanë kapur regjistrat me dorë. Në klasa hyjnë ose me duar në xhepa, ose kanë hapur një fletore, të cilën e përdorin si regjistër. Nxënësve të shkollave tetëvjeçares dhe të së mesmes, mësuesi u kujton nxënësit pa interesa, që vijjnë në shkollë me një fletore në xhepin e pasëm të pantallonave. Herë-herë ua fshehin "regjistrat" mësuesve dhe shpejt e shpejt fshijë ndonjë

mungesë, kur rrezikohen për t'u përjashtuar nga shkolla për shkak të mungesave të shumta. Edhe po t'i kapi mësuesi me presh në duar, nuk ka se çfarë t'u thotë. Një fletore kurrë nuk merr rëndësinë e një dokumenti si regjistri. Në fletore nuk mund të vendosësh as notë, kështu që edhe më tej arsimit nënvleftësohet në mënyrë skandaloze. Kur pyet drejtuesit e shkollave, nuk merr asnjë përgjigje. Me ç'duket tenderin do ta

ketë fituar ndonjë militant që nuk e di çfarë do të thotë shtypshkrime dhe paratë e regjistrave të shkollave të Beratit, një Zot e di se në ç'xhepa flenë. Për të prodhuar regjistrat e shkollave të Beratit një shtypshkronje i nevojiteshin jo më shumë se një javë.

Mësuesit, këto qënië të urta shoqërore presin dhe shpresojnë se bashkë me ardhjen e regjistrave do t'u rritet edhe rroga.

Lajmëtari

## Tregu ushqimor i lagjes "Çlirim", burim sëmurdjesh

BANORËT e lagjes "Çlirim" në qytetin e Beratit konsumojnë çdo ditë ushqime që mund t'u rrezikojnë shëndetin. Tregu ushqimor i fruta-perimeve zhvillohet në ish -rrugën e "NSHG-së" në afërsi të shkollës "28 Nëntori". Ndonëse një rrugë automobilistike, që lidh lagjet e qytetit, kjo rrugë vitet e fundit është shndërruar në një vend tregtimi. Nga të dyja anët e saj në tezgat të vendosura shkujdesur me mjete rrethore tregtohen ushqimet e përditshme që nga mishit, bulmetrat, frutat dhe perimet. Ky vend tregtimi shërben si i tillë për disa prej lagjeve me një popullsi prej 2 mijë banorësh. Tregtarët çdo ditë instalojnë tezgat e tyre. Ushqimet që tregtohen, qëndrojnë mes pluhurit, mbeturinave, shiut në rast rreshjesh, baltës. Duke mos patur vend tjetër tregtimi rreth 20 tregtarë mundohen të jenë në punë duke shitur këtu, ndonëse shprehen të ndërgjegjshëm se ushqimet nuk mund të tregtohen në rrugë. Nga ana e tyre konsumatorët e shohin si të vetmin treg më të afërt për të blerë ushqimet e përditshme, ndonëse ato mund të shkaktojnë raste

sëmurdjesh. Qytetarët që duken si të "mësuar" me këtë fakt, i sheh çdo ditë të ngarkuar me qeska nëpër këtë treg që vetëm i tillë nuk mund të quhet. Nga ana e tyre tregtarët që ndihen të rrezikuar dhe nga qarkullimi i automjeteve duke



qëndruar në anë të rrugës, shprehen se disa herë e kanë ngritur këtë problem pranë bashkisë, por asgjë nuk është bërë, ndonëse premtime për ndërtimin e një tregu janë bërë pa masë.

Eriola Azizolli

## Të sëmurët duhet t'i përballojnë vetë nevojat për ilaçe

Në spitalin e Beratit, edhe pse kujdesi i mjekëve nuk mungon, vërehet kriza për ilaçet më të domosdoshme për të përballuar sëmundjet ose operacionet. Të afërmit e të sëmurëve duhet t'i përballojnë vetë nevojat duke i blerë ilaçet sipas rekomandimit të

mjekut. Pas një operacioni anti-otikët për të luftuar sëmundjen ose infektionin, nuk gjenden në spital. Se ato janë tepër të shtrenjta. Vetëm për një kurë të tillë brenda një jave duhet të harxhohen nga pacienti shtatë mijë e pesëqind lekë të reja. Ka

ilaçe që kushtojnë edhe më shtrenjtë. Mirë ai që ka mundësi financiare mund ta përballojë këtë nevojë, po ai që nuk ka ç' duhet të bëjë? Ndoshta duhet ti nënshtrohet fatit.

Lajmëtari

## Vlerësimi i potencialit intelektual, shprehje e emancipimit të shoqërisë

PASIONI dhe bagazhi intelektual janë një thesar për shoqërinë, vlera që po nuk u shfrytëzuan përfillen në kohë humbasin me brezat. Parapëlqimet vetjake janë të përkohshme dhe të pjesshme, por, mbi të gjitha, vlerat kombëtare kërkojnë përgjegjësi, vlerësim real, pa dallime e ngjyrim.

Njohja e historisë dhe e vlerave kulturore artistike të një qytetërimi, që përfaqësohet me vazhdimësi etnike në trevën e Beratit, mbetet detyrë dhe kërkon këmbëngulje të përhershme nga të gjithë për t'u thelluar në punën e tyre, në intelektin që disponojnë, që ta nxjerrin në dritë e ta pasurojnë vazhdimisht me material faktik. Ndodh e do të ndodhë që në çaste të caktuara, "cipëza" në sytë e pushtetarëve të të gjithë kategorive, pengon apo bëhet barrierë në vlerësimin e pasqyrimin me vërtetësi të historisë. Këto pengesa kapërcehen lehtas, kur komuniteti ka kulturë demokratike. Shkalla e emancipimit të shoqërisë pasqyrohet në thellësinë e kuptimit të vlerësimit të ngjarjeve e dukurive, në kufijtë e realitetit kohor kur janë zhvilluar, vlerat që ruajnë, dhe vendin që zënë në atë epokë historike kur zhvillohen.

Në zyrat e pushtetit vendor ka një rreze, shprese por e vagëlluar, ka premtime, por e vërteta varet sa dhe si do ta vlerësojë këshilli bashkiak. Kur është fjala për të ndritur labirintet e vlerave të kulturës dhe historisë sonë kombëtare, vlerat e përmasat e një figure të këtij niveli, besoj se është e padiskutueshme të mbash dorën e të japësh kontribute materiale me pikatore.

Mendoj se është e udhës që vlerat financiare që lëvrohen, të përputhen me vlerat kombëtare që pasqyrohen në tirazhin e një veprë.

Për t'i dhënë një shtrirje më të gjerë mendimit, përveç administratës shtetërore, ka edhe burime të tjera që duhen shfrytëzuar, ashtu si është vepruar në shumë raste për botime të reja.

Të interesuar janë jo vetëm autorët, por edhe familjarë e të afërm pa lënë pas dore atë kategori biznesmenësh të cilët nivelin intelektual e shprehin me kontributin financiar që japin për pasqyrimin e propagandimin e vlerave historike e kulturore të kombit.

Te ne në këtë drejtim është punuar e punohet pak për mbajtjen gjallë të ndjenjave patriotike, që Berati të ruajë vendin e nderit me vlerat unikale që ka.

Këto pak fakte janë një pjesë e shfaqjes

së aisbergut potencial intelektual që rri në pritje për t'u shfrytëzuar. Tepër sinjifikativ mbetet fakti që pas daljes në pension, të paktë janë intelektualët apo profesionistët, mjeshtrat, që vazhdojnë të aktivizohen e kontribuojnë

Shumica e tyre mbetën në pasivitet të plotë, pa përmendur këtu idetë përcmuese për këto vlera. Kjo kategori qytetarësh thirren vetëm kur dikton nevoja, për probleme specifike, në vend që të jetë një stol rezervë për ta.

Marrja në konsideratë e këtij potenciali, jo për forcë, por për mend, është ndihmesë për mbajtjen gjallë të traditave në të gjitha sferat e zhvillimit social-ekonomik, politik, kulturor e artistik të shoqërisë. Shkenca dhe shoqëria do të ecin përpara, sepse e tillë është dialektika e zhvillimit, rotacion në histori, por vlerësimi i përvojës së brezave është një akt qytetar, një shprehje e shkallës së emancipimit shoqëror. Nuk humbim veç fitojmë kur qëmtojmë nektarin e kulturës sonë e të asaj që trashëgojmë nga brezat paraardhës ...

Nga shumë shkrimtarë e studiues botëror ka superlativa për qytetin tonë. Ata e quajnë Beratin kryeqendër, kryeqytet të Shqipërisë së Jugut. Nga thellësitë e shekujve (shek. VI-V para erës së re), ky vendbanim i hershëm me një vijueshmëri kombëtare, me një kështjellë të ruajtur që nga shekulli i tretë, kjo kryeqendër e kulturës sonë ka një histori për t'u admiruar. Kodikët e famshëm, unikal për llojin e vet, një mori afreskesh, shkolla më e lashtë e pikturës dhe bukurshkrimit, kur edhe kontinenti plak nuk i kishte njohur dhe sa e sa relike të historisë me origjinalitet të admirueshëm, janë shprehje e një kulture tepër me vlerës në nivel botëror.

Të ecësh pas gjurmëve të beratasve gjenialë, si një ushtar i kulturës, është nder tepër i madh.

- ... Kam jo pak tituj kombëtar e ndërkombëtar dhe ky që më jepni ju sot "Qytetar Nderi i Qarkut", qëndron denjësisht përkrah tyre, si diçka krejt e veçantë, si diçka krejt origjinale. Më duket vetja si një ushtar modest, se në histori po ecet në gjurmët e desaretëve ilirë, - u shpreh akademiku Bedri Dedja në ceremoninë e dorëzimit të titullit që iu akordua.

Në histori ka vend për të gjithë, ashtu si ka vend dhe nevojë bota e shoqëria për kontributin e të gjithëve.

Namik Gjoni

# Jaser Arafat- krijesë e KGB-së

Nga Jon Mihai Pacepa

Marrë nga gazeta *IL giornale* e 24 shtatori 2003

QEVERIA izraelite ka vendosur dëbimin e Jaser Arafatit, duke e përcaktuar si një "pengesë" për paqen. Por 72-vjeçari, lideri palestinez, është më tepër se një pengesë, sepse është një terrorist karriere, i stërvitur, armatosur dhe i furnizuar prej dhjetëra vitesh nga BS dhe vendet e tija satelite.

Para se të arratisesh nga Rumania e të shkoja në Amerikë, duke lënë vendin e kryetarit të shërbimeve sekrete rumune, kisha si detyrë t'i jepja Arafatit çdo muaj, gjatë gjithë viteve '70, rreth 200 mijë dollarë në dorë, veç të tjerash, dërgoja në Beirut çdo javë dy aeroplanë transporti plot me uniforma e furnizime të tjera. Vendet e tjera të bllokut sovjetik bënin të njëjtën gjë.

Terrorizmi për Arafatin ka qenë përparësi e tij.

Sipas revistës Forbes, ai sot është një nga shtatë njerëzit më të pasur nga mbretërit dhe diktatorët me afro 300 milionë dollarë të fshehura në llogaritë e bankave të Zvicrës.

-Vetë unë kam qenë ai që kam shpikur ndryshimin e kursit të avionëve të linjave, - tha me mburrje Arafati, kur u takova me të për herë të parë në Kuartierin e tij të Përgjithshëm në OLP të Beirutit në fillim të viteve '70. Pastaj iu afrua flamurit të kuq i fiksuar në një hartë gjeografike të botës varur në mur, e cila shënonte Izraelin si Palestinë.

-Palestina është aty, - më tha me krenari. Në të vërtetë devijimi i kursit të avionëve i përket KGB-së, e cila devijimin e parë të aeroplanit të pasagjerëve të SHBA-së e bëri në vitin '60 në Kubën komuniste.

Veç të tjerash, e reja e Arafatit kanë qenë kamikazet, një koncept terrorist, që do të arrinte kulmin më 11 shtator.

Më 1972 Kremlini e vuri Arafatin dhe rrjetin e tij terrorist në krye të listës prioritare të të gjitha shërbimeve sekrete të bllokut sovjetik, përfshirë edhe mua. Detyra e Bukureshtit ishte ajo e të qenit të preferuar nga Shtëpia e Bardhë. Në këtë çështje ne ishim ekspertë të bllokut. Tashmë kishim arritur suksese të mëdha në besimin që kishte Washingtoni, sepse pjesa më e madhe e akademikëve amerikanë të së majtës së asaj kohe thoshin se Çausheku ishte si Josif Broz Tito, një komunist i "pavarur" me një sens të "moderuar".

Kryetari i KGB-së Juri Andropov, në shkurt të vitit 1972 më buzëqeshi me ironi për famën e jankive. Tashmë ishim çliruar nga kulti i individit të Stalinit, por ata amerikanë të çmendur ishin shumë naivë, kur nderonin liderët kombëtarë. Ne e kishim bërë Arafatin si një farë "njeriu prej kashte" dhe do ta sillnim gradualisht në OLP-in, gjithmonë e më pranë "shtetit". Andropovi mendonte se amerikanët të sflitur nga Vietnam, në shpresën e tyre për paqe, menjëherë do të prisnin shenjën më të vogël për pajtim, duke shndërruar Arafatin nga terrorist, në burrë shteti.

Kjo gjë m'u bë e qartë nga "kartela personale" e KGB-së për Arafatin. Bëhej fjalë për një qytetar egjiptian të transformuar në një marksist të devotshëm nga shërbimet e huaja sekrete të KGB-së. KGB-ja e kishte stërvitur në shkollën e saj speciale jashtë Moskës dhe aty nga viti '70 vendosi ta përgatiste për t'u bërë lider i ardhshëm i OLP-it.

Para së gjithash KGB-ja zhduku të gjitha regjistrimet e gjendjes civile të lindjes së Arafatit në Kajro, duke i zëvendësuar me dokumente falso, prej të cilave rezultonte se Arafati ishte lindur në Jeruzalem, pra i lindur në Palestinë.



Reparti i dizinformimit të KGB-së vuri në punë një broshurë për Arafatin të përbërë prej katër faqesh të quajtur "Falastinuna" (Palestina jonë) dhe më pas e transformoi në një revistë mujore prej 48 faqesh për organizatën terroriste të AL-Fatahut.

Arafati e kishte udhëhequr Al-Fatahun qysh nga 1957. KGB-ja shpërndau revistën në të gjithë botën arabe edhe në Gjermaninë Lindore, e cila aso kohe priste shumë studentë palestinezë. KGB-ja kishte detyrën e publikimit dhe të shpërndarjes së revistës në disa gjuhë për disa organizata që vepronin në Evropën Perëndimore, si p.sh. Këshilli i Paqes Botërore, Federata Botërore e Shoqërive Sindikaliste etj. Më pas KGB-ja i dha Arafatit një ideologji dhe një imazh, ekzaktësisht siç bëri për komunistët besnikë të organizatave tona në frontin ndërkombëtar. Idealizmi shpirtmirë, nuk kishte shumë peshë në masën e botës arabe, pra KGB-ja e rimoderoi Arafatin si antisionist të tërbuar. Midis të tjerash, zgjodhi për të një model prej "heroi" si Myftiu i Madh Haj Amin al Hussein, njeriu që vizitoi Aushvicin në fund të viteve '30, i cili qortoi gjermanët se nuk kishin vrarë çifutë aq sa duhej. Më 1985 Arafati i bëri nderime Myftiut, duke thënë se ishte tepër krenar që po ndiqte gjurmët e tij. Arafati ishte një maskë për KGB-në. Menjëherë pas Luftës Arabo-Izraelite, të shtatë ditëve më 1967, Moska e emëroi atë President të OLP-it.

Propozimin për emërimin e tij e bëri kukulla sovjetike Abdel Gamal Naser. Në vitin 1969 KGB-ja i kërkoi Arafatit t'i deklaronte luftë "imperializmit sionist" amerikan me rastin e samitit të parë të Terrorizmit të Zi Ndërkombëtar, një organizatë neofashiste filopalestineze e financuar nga koloneli i Libisë Mohamed Gadafi. Kjo gjë i pëlqeu aq shumë Arafatit, sa që më vonë pretendoi se ishte ai që shpiku thirrjen për luftë kundër "sionizmit imperialist". Në të vërtetë "imperializmi sionist" ishte një shpikje maskovite, një adaptim modern i "Protokollit të të Urtëve të Sionit" e për më tepër një nga instrumentet më të pëlqyera të shërbimeve sekrete ruse, për

të nxitur urrejtjen etnike. Gjithmonë KGB-ja e ka konsideruar antisionizmin dhe antiimperializmin si një burim të pasur të antiamerikanizmit. Në kartelën e KGB-së për Arafatin, thuhej, midis të tjerash, se në botën arabe, vetëm njerëzit me të vërtetë të aftë në mashtrim, do të mund të arrinin shkallët më të larta. Ne rumunët ishim ngarkuar të ndihmonim Arafatin në përmirësimin e "talentit të tij" të jashtëzakonshëm, në të mësuarit për të gënjer.

Kryetari i KGB-së për shërbimet e huaja sekrete, gjenerali Aleksandër Saharovski, na urdhëroi

Në kartelën e KGB-së për Arafatin, thuhej, midis të tjerash, se në botën arabe, vetëm njerëzit me të vërtetë të aftë në mashtrim, do të mund të arrinin shkallët më të larta. Ne rumunët ishim të ngarkuar të ndihmonim Arafatin në përmirësimin e "talentit të tij" të jashtëzakonshëm, në të mësuarit për të gënjer.

Kryetari i KGB-së për shërbimet e huaja sekrete, gjenerali Aleksandër Saharovski, na urdhëroi të kujdeseshim për një mbulesë në veprimet terroriste të Arafatit, në të njëjtën kohë të forconim imazhin e tij ndërkombëtar. "Arafati është një teatrosi brilant i fesë", përfundonte dokumenti dhe ne duhej të merrim fruta nga kjo aftësi.

Në mars të vitit 1978 solla fshehtas në Bukuresht Arafatin për t'i dhënë instruksionet përfundimtare se si ai duhej të sillej me Washingtonin. "Ai thjeshtë duhej të vazhdonte me këmbëngulje se do të prishej me terrorizmin e do të njëjthe Izraelin". "Duhet ta përsëritësh vazhdimisht", i tha Çausheku më se një herë. Çausheku ishte euforik para perspektivës që Arafati do të mund të merrte çmimin Nobel për paqe në shfaqjen e rreme të tundjes së degës së ullirit.

Në prill të vitit 1978 e shoqërova Çaushekun në Washington, kur ai arriti të magjeps presidenti Karter. Arafati tha se do ta transformonte organizatën brutale të OLP-it në një qeveri në ekzil që respekton ligjet, nëse SHBA do të vendoste marrëdhënie zyrtare. Takimi ishte sukses i madh për ne. Karteri përshëndeti Çaushekun, diktatorin me shtetin më policor në Evropën Lindore, si një "udhëheqës i madh kombëtar e ndërkombëtar", që kishte "marrë përsipër një rol prej lidhësi në tërë bashkësinë ndërkombëtare. Triumfues, Çausheku solli në shtëpi një komunikatë, në të cilën presidenti amerikan deklaronte se lidhjet e tija miqësore me Çaushekun ishin në shërbim të "kauzës botërore".

Tre muaj më vonë SHBA më dha strehim politik. Çausheku nuk e mori dot çmimin Nobel. Por më 1994 Arafati e fitoi atë, sepse ai kishte vazhduar të recitonte me përpikmëri deri në perfeksion rolin që i ishte besuar. Ai kishte transformuar organizatën e tij terroriste OLP në një qeveri në ekzil (Autoriteti Palestinez), gjithmonë duke u shtirur se po frenonte terrorizmin palestinez, ndërsa në të kundërtën e lejonte të shpërthente pa pushim.

Dy vjet pas Akordit të Oslos, numëri i të vrarëve nga terroristët palestinezë u ngjiti në 73%. Më 23 nëntor 1998 presidenti Klinton pushoi së kontestuari Arafatin publikisht, duke e falënderuar për "dhjetëra e dhjetëra vjet përfaqësimi të palodhur para botës, dëshirën e popullit palestinez për të qenë i lirë në atdheun e vetë".

Administrata aktuale e ka kuptuar farsën e Arafatit, por asnjëherë nuk mbështet publikisht dëbimin e tij.

Ndërkohë terroristi plak ka kontrollin e tij të plotë mbi Autoritetin Palestinez dhe ka rreshtuar pasuesit e tij të rinj për të zgjeruar akoma më shumë numërin e sulmeve terroriste.

**Përktheu : Bardhyl Myftiu**

## Në rrugën e shqiptarizmit

Pas atij manifestimi kaq entuziast e mbresëlënëse të jetuar në Prizrenin historik para dy vjetëve, Tirana mblodhi sërish delegatë nga gjithë bota për Lidhjen Shqiptare në Botë. Këtë radhë ishin thirrur në një takim të ngrohtë përfaqësues nga Kosova, Maqedonia, Çamëria, nga Italia e Kroacia, nga Mali i Zi e nga mjaft vende të tjera të botës për të bërë bilancin e punës pas dy viteve e për të përgatitur punimet e Kongresit të dytë të kësaj Lidhjeje, që do të mbahet në Tiranë.

E në këtë kuvend të shqiptarizmit, edhe Berati kishte vendin e vet. Me kulturën

e mesazhet e së ardhmes që përcjell ky qytet në mbarë trojet shqiptare.

Mes këtij zëri kaq të fuqishëm ritakum të papërtuarën VITORE STEFËN. Ferri i diktaturës nuk ia ka zbehur pasionin e shqiptarizmit, humanizmin e saj ndaj çdo shqiptari kudo ku ndodhet. Në krah ka vajzën e saj Mardena, tashmë e afirmuar edhe në fushën e poezisë me vëllimin e fundit poetik të titulluar "FJALA QË TË JETOJ"

Si gjithnjë organizatore të afta, ato takojnë e diskutojnë me miqtë e ardhur. Vetë Vitorja, posa kishte ardhur nga Kosova ku po punonin për të vendosur bustin e shqiptares së madhe Nënë Terezës. Vetëm një fotografi

e madhe e Beratit aty në hollin e hotel "Dajtit" që u desh të kalohej në duart e pjesëmarrësve, e bëri atë të ulej në gjunjë të përlojtë e ta puthte me me mall disa herë.

Me mirënjohje të veçantë drejtuesit e kësaj Lidhjeje, vëllezërit Simon e Mikel Kuzhnini, përpara personalitetëve më të larta të shtetit e të diasporës iu drejtuan edhe sponsorit të përgjithshëm të kësaj veprimtarie z. Muhamet Muçaj, President i Kolegjit KRISTAL. Emocionet e këtij takimi do të ishin të paplota, nëse nuk do të shkruanim për Rajmonda Maleçkën, një vajzë me origjinë nga Dibra e banuese në Tiranë. Pasi kishte marrë pjesë me armë në dorë në luftën për çlirimin e Kosovës, ajo kishte shkruar një libër për UÇK e këto ditë posa kishte mbaruar një film dokumentar për

dëshmorët e rënë në trojet shqiptare në Maqedoni. Pamje tepër mbresëlënëse e autentike nga Gostivari, Kërçova. Nga mallet e skenat e improvizuara në sheshet e luftës ta mbanin deri në fund të gjallë emocionin. Dhe ja, befasisht, na shfaqet një djalë Berati që i rreshtohet këtyre dëshmorëve. Quket Lefter Bici, e ndjek rrugën e dëshmorit tjetër beratas nga Lumasi, i cili ra në luftën e Kosovës para 4 viteve.

E uruam Rajmondën për punën e saj fisnike e plot sakrificë. Në një farë mënyre ajo, Vitorja, Madrena ....të gjithë ishim bërë zëdhënës të shqiptarizmit aq të lakmuar për të gjithë në këtë fillimshkulli të ri.....

**Namik Selmani, Sotiraq Mishaxhiu anëtarë të Lidhjes Shqiptare në Botë**

## Bashkia e qytetit shpërndan tituj nderi për personalitete të spikatura

**BASHKIA** e qytetit të Beratit ka dhënë disa tituj nderi për disa personalitete të spikatur që kanë dhënë kontributin e tyre në shërbim të komunitetit të këtij qyteti. Ditën e premte rreth

Carbone, përfaqësuese e komunitetit katolik në këtë qytet, andërsa në emër të ambasadorit të Çekisë mori pjesë një e dërguar, në mungesë të ambasadorit Miroslav Sindelar.



Nga ceremonia e dhënies së titujve

orës 11.00 bashkia organizoi në mjediset e pallatit të kulturës "Margarita Tutulani" ceremoninë e ndarjes së titujve.

Aktiviteti nisi me pritjen e personaliteteve të huaja dhe të komuniteteve fetare në zyrën e kryetarit të Bashkisë Niko Mata.

Përveç pushtetarëve lokalë dhe të ftuarve në këtë takim morën pjesë vetë personalitetet që u nderuan nga kreu i bashkisë me tituj nderi: Marcelo Fondi, konsulli i përgjithshëm i konsullatës italiane në Vlorë, Hans Heinrich Ahfelfld, drejtori i përgjithshëm i projektit Shqiptaro-Gjerman, në Tiranë, Qeramudin Durdia ish- Myfti i Beratit, hirësia Ignat Triantis i komunitetit Orthodoks në Berat, suor Franca

Ceremonia e dhënies së titujve u zhvillua rreth orës 11.00 në sallën e katit të dytë të pallatit të kulturës. Titujt e nderit u ndanë personaliteteve me motivacionin "për kontribute të dhënë në shërbim të komunitetit beratas".

Nga ana e tyre personalitetet falenderuan për titujt këshillin bashkiak dhe shprehën mirënjohjen për vlerësimin që iu bë, duke premtuar bashkëpunim më të ngushtë në të ardhmen. Më pas aktiviteti u mbyll me një koncert të muzikës simfonike nën drejtimin e dirigjentit Fatbardh Dervishi.

Eriola Azizolli

## "Hiqni pularinë nga qendra e fshatit, ndryshe do të bojkotojmë zgjedhjet

### Banorët e fshatit Otllak petition KQZV-së

"Na hiqni pularinë e ndërtuar në qendër të fshatit, ndryshe nuk do të marrim pjesë në votime duke bojkotuar zgjedhjet", - kështu janë shprehur në një petition dërguar komisionit Qendror të zgjedhjeve banorët e fshatit Otllak në rrethin e Beratit. Në emër të banorëve mësohet të kenë firmosur 130 persona, të cilët me anë të petitionit kanë kërkuar heqjen e pularisë që ndodhet mes fshatrave Otllak dhe Orizaj, pasi, sipas tyre, është e rrezikshme për shëndetin, në të kundërt ata janë shprehur se do të braktisin zgjedhjet vendore. Ditët e fundit banorët mësohet t'i jenë drejtuar komisionit zonal të zgjedhjeve dhe, kur atje nuk e kanë pranuar petitionin, e kanë dërguar në



Pamje nga pularia

adresë të KQZV-së. Një pulari e ndërtuar mes dy fshatrave shumë pranë qendrave të banimit dhe e papajisur me filtrim është bërë shkak që banorët të kërcënojnë mospjesëmarrjen në votim. "Po na sëmuren fëmijët nga ajri i ndotur që vjen nga pularia"; "Të merren

masa sa më shpejt për heqjen e kësaj pularie nga mjediset e banuara, përndryshe nuk do të marrim pjesë në zgjedhjet e 12 tetorit", - kështu mësohet të jenë shprehur banorët në petitionin e tyre dërguar KQZV-së.

Eriola Azizolli

## Rrugë të mbetura pa trotuare

**KUR** jepet fondi për një rrugë të re apo për të bërë rirregullimin e saj, nuk jepet vetëm për të bërë shtrimin e korsisë ku do të kalojnë automjetet (e kemi fjalën për rrugët brenda për brenda qytetit), por jepen fonde për tërësinë dhe mobilimin me përbërësit kryesor të saj.

Ç'ndodh me fondet e rrugëve? Ato jo vetëm që cungohen që në "lindjen" e tyre, sepse do pjesën e tij ai që e siguron këtë fond (sikur janë nxjerrë nga pasuria e babait), pjesë do dhe ai që bën shpërndarjen dhe siguron dhënie të tenderit, jo i firmës që ofron çmimin më të lirë për përfundimin e rrugës, por ai që premtim se do të japë më shumë para nën dorë. Kështu që, fondi i ngelur mjafton vetëm për të bërë një rrugë dosido. E keqja nuk mbaron këtu. Për rrugët, nuk janë të mjaftueshme dhe të nevojshme vetëm ndërtimi i korsisë së shtruar me asfalt, por, siç thamë, dhe rirregullimi aty ku janë trotualet, ndërtimi i të rinjve aty ku mungojnë, që të kompletohen me tërë pajisjet e tyre, si pllaka, drita dhe gjelbërimi me pemë.

kthyer në vendhedhje mbeturinash. Nga të dy anët janë mbushur me ferra e bimë të tjera të egra. Nga njëra anë janë mbjellë disa rrepe dekorative, por nga njerëz të papërgjegjshëm ose nga keqbërës të ndryshëm, që vetëm emrin qytetar dhe normalë nuk e meritojnë, ato ose janë thyer, ose janë prerë. Për t'u lavdëruar është këmbëngulja e drejtorit të lulishteve, zotit Kafexhiu, që e ka mobiluar disa herë këtë segment rruge.

Kush i favorizon keqbërësit, apo t'i quajmë pemëprerësit e rrugës? Mendoj se edhe ndriçimi normal i këtij segmenti që nuk është bërë fare. Nëse do të kishte ndriçim normal, do të ishte më e zorshme prerja dhe dëmtimi i pemëve. Kësaj rruge i mungon dhe sinjalistika si ajo horizontale dhe ajo vertikale. Kjo nuk duhet të ndodhte. Rruga agjensi- Uznovë është rrugë e brendshme e qytetit. Të mos harrojmë se Uznova nuk është më qendër rurale, por pjesë e qytetit. Në këtë lagje është instaluar dhe funksionon



Rrugë pa trotuare

Po çka ndodhur me rrugët tona? Vërtetë janë bërë disa ndërhyrje nëpër rrugët ekzistuese. Në disa prej tyre, nga abuzimi me fondet ose nga shpërndarja e fondit në dy -tri objekte, rrugët nuk janë plotësuar me trotuare. Për aksin agjensi-spital nuk do të flasim për cilësinë e dobët, por dhe për marrjen në dorëzim nga supervizori qorrazi. Për mungesën e trotuarit nga rrapi i kthesës së shkollës "Thimi Tani" gjer në kthesën e spitalit, fondi i këtij segmenti (nga të dy anët), sipas punëtorëve që punojnë aty, i ishte dhënë lagjes "Dëshmorët e Kombit", por trotualet, dhe kjo me qëllim, për të hedhur hi syve se, gjoja, bashkia, qeveria a deputeti po mendon për lagjen e tij. Po e njëjta dukuri është vënë re edhe në segmentin spital-Uznovë, mungojnë trotualet nga të dy anët. Në njërin anë, është bërë një mbushje anësore me çakull, vetëm kaq, nga ana e lumit, kur shkon për në Uznovë, duhej ndërtuar dhe një murmbajtës për dherat. Nga rreshjet që kanë rënë, ka ndodhur rrëshqitja e tokës dhe çarja e bazamentit të trotuarit. Kurse nga ana e ish-repartit, as që bëhet fjalë për skicimin e ndonjë trotuari, por dhe nga ana tjetër, janë vetëm bordurat kufizuese nga korsia e kalimit të automjeteve. Nga të dy anët e rrugës, këto që duhet të ishin trotuare ku do të kalonin këmbësorët që nuk udhëtojnë me mjete, janë

bashkia e rajonit numër 4, rajon dhe bashki që duhet të ishte një lloj e vlerësuar nga bashkia qendrore. Duket se dhe kjo bashki pak ka "qarë" te bashkia mëmë e Niko Matës. Dihet se fëmija që nuk qan, nuk i jep gjë e ëma. Kur fëmija ia këput gjumit natë e ditë, atëherë nëna as që do t'ia dijë fare për të. Mbase dhe këtë vit do të ndiqet taktika, në çdo zgjedhje një gjysmë rruge, siç janë nisur disa të tilla, njëra syresh përfundoi pa lidhur as edhe një qendër banimi me një tjetër. Se cili qe qëllimi i kësaj rruge 300 milionëshe (të vjetra, se allah, allah na hidhni në gjyqë përsëri për presjet dhjetore), një zot e di.

Rrugët presin trotualet, trotualet presin fondet, njerëzit presin të kalojnë të sigurtë në këto rrugë, ku jo rrallë bëhen gara me makina. As në hyrje, e as në dalje të këtij segmenti nuk gjen një shenjë ku shoferët të detyrohen të ulin shpejtësinë, të tregojnë kujdes se po kalojnë në zona të banuar, të jenë të vëmendshëm se në këtë rrugë kalojnë fëmijë, se ka shkolla pranë. Rrugët gjysmake nuk i hyjnë në punë kërkujt, përpos atyre që i hanë fondet dhe ia dinë kimetin lekut të fituar në rrugë të pandershme. Dhe të tillë në Berat nuk ka pak.

Bujar Orizaj

# Të vdekurit kërkojnë pensionin e pleqërisë



Vasillaq Kumani

## Tregim humoristik

**TOMI** nuk u besonte syve, kur lexoi në listat elektorale të lagjes së tij emrin e babait, që kishte tridhjetë e kusur vjet që ishte larguar nga kjo gjallane.

-Ç'është kjo,- tha me zë të lartë, - jam unë i shkalisur apo të tjerët që na kanë ngjallur?

- Ej, - e shkundi nga kjo dalldisje Pertefi, - çfarë të gjeti?

-Po shiko, more, - duke mos i hequr sytë nga lista, - shiko, babai i gjallë!

-Po nuk thua shqyr?

Tomi rrotulloi kokën dhe pa shokun e tij të ngushtë, që i qëndronte fare pranë. Në fytyrën e stomatologut lodronte një e qeshur që e bëri Tomin të çmendej.

-Po shiko, more, se çfarë kanë, bërë - bërtiti gjithë nerva, - babai i gjallë dhe ti më zgërdhësh!

-Lëre, - u përpoq ta qetësonte Pertefi duke vazhduar gjithnjë të qesh, - nuk është as i pari dhe as i fundit, unë kam parë gjyshin e komshiut tim që ka vdekur në një mijë e nëntëqind e njëzetën.

-Dhe pastaj? - e pyeti me habi Tomi.

-Pastaj hiç, le të rrinë atje ku janë dhe këtu të abstenojnë.

-Përse të abstenojnë? Jo, këtë unë nuk e lë me kaq.

-Po si është e mundur xhanëm? Ata të gjendjes civile nuk i kanë regjistrat?

-I kanë.

-Po atëherë?

-E po hë, ma thuaj ti, se edhe unë nuk i jap dot dum kësaj pune. Disa të vdekur i kanë përdredhur kokën si puna e babait të gruas sime.

-Do të jetë ndonjë që i ka trazuar atje. Hajde, - ia bëri Tomi dhe e zuri prej krahu Tefin dhe filloi ta tërheqë me forcë.

-Ku më çon?

-Drejt e në KQZV.

-Dale, dale, mos u ngut, sot është ditë pushimi dhe nuk gjen njeri. Me sa kam marrë

vesh unë puna e babait tënd është pak e ngatërruar.

-Pse?

-Sepse duhet bërë gjyq që të kthehet nga i gjallë në të vdekur. Vetëm kështu mund të hiqet nga lista, prandaj e lëmë për nesër këtë punë.

Në mbrëmje Tomin e marrin në telefon. Një zë i hollë si ndonjë fije peri që mund të këputej në çast, i dha lajmin tronditës: "Pertefi pësoi papritur një atak në zemër dhe ... mbaroi".

Tomi e gdhui atë natë në dhomën e burrave me shumë të tjerë. Kurse në dhomën e grave, Pertefi qëndronte shtrirë veshur me një kostum të zi firmato.

U bë ceremonia mortore, hodhën të gjithë nga një lopatë dhe doktor Pertefi zbriti në botën tjetër.

Porsa zbriti, një si erë myku rrobash të vjetra të nxjerra nga syndyqe mijëvjeçare, i shpoi hundët. Nuk kuptonte gjë, nuk mund të thuhej nëse ishte natë mugëtirë. Ishte diçka e papërcaktuar, ku ndihej vetëm kërcitje kockash.

Në atë hapësirë boshe endeshin si në një valle gjethesh që bien nga pemët, skelete të plota, të tjerë që kishin brinjë mangët dhe të tjerë e të tjerë vetëm me shtyllën kurrizore me kafkën e thatë ku shquheshin vetëm gropa e brima. Pertefi ecte dhe hera -herës mbërthehej në vend nga habia: skelete kockash të fosilizuara lëviznin duke kërkuar njëra-tjetrën, disa të tjera që lëviznin nuk shquheshin dot, dukeshin si të përbëra prej fasha mjegullash. Pertefi ecte kuturu pa ditur as vetë se çfarë kërkonte. Kur, papritur, i del përpara një zotëri i tëri i kollarit në të zeza. Iu bë si një fytyrë e njohur.

-Më falni, mos jeni ju babai i Kudretit dhe Seferit?

-Unë jam, pse, ti kush je?

-Unë jam doktor Pertefi, kemi jetuar bashkë në një lagje.

-Nuk të njoh.

-Para katër ditësh hëngra drekën tënde. Ke djem të shkëlqyer, djem të hajrit. Të prunë nga Amerika për të varrosur në tokën mëmë, pranë njerëzve të tu.

-Ashtu është. Kanë gjithë uratat e mia, por jam i trishtuar, sepse më ngeli atje një miku im i ngushtë, Trifoni, Trifon Kalaja.

-Pse vdiq Trifoni?

-Ou, po bën afro një vit. atij ia drodhën bukur.

-Dy, për operacionin e

Ai nuk shkulej nga Shqipëria, do të vdes këtu thoshte.

Dhanë e morën dhanë e morën dhe më në fund ia mbushën mendjen me një copë letër ku betoheshin se, mbas vdekjes, do ta binin për ta varrosur këtu. Ai e mbante në xhep letrën dhe herë pas here ua tregonte. Ua thashë djemve kur vdiq dhe e varrosën atje. "Turp të kini, lëshuat dhe deklaratat!". Njëra nga nuset ma ktheu: "Ou... pse çfarë do ai, ja, vend më të mirë se ky nuk ka ku gjen, e kemi vënë fare pranë presidentit Linkoln!".

Këtë të fundit Pertefi nuk e dëgjoi, sepse ia tërhoqi vëmendjen një skelet në formën e tij të plotë me atë lëkurën e tharë ngjitur pas kockave. E njohu vetëm nga protezat që ia kishte punuar vetë tre herë radhazi dhe asnjë herë nuk i puthiteshin mirë.

-Ti, Nafije je?

-Unë jam, - u përplasën vetëm protezat, se nga buzët s'kishte mbetur gjë.

-E pamundur, - bërtiti Pertefi (u ndjenë kërcitje kockash skeletesh që afroheshin) - ti je lartë, e gjallë. Unë para dy ditëve vura re dhëndrin që tërhoqi pensionin tënd.

-Ke të drejtë, ke shumë të drejtë, sepse ai nuk di asgjë për këtë që më ndodhi, as qeveria nuk di gjë. Ma merr mendja se dhëndri nuk ka dashur të s'këllidise qeverinë, se mjaft është copëtuar me të tjerë të humbur dhe nuk ka nxjerrë gjë në shesh. Që ta marrësh vesh ti, puna ka rrjedhur kështu: Kisha vetëm një vajzë dhe u mbështeta te dhëndri. Dhëndri nga gjendja shumë mirë, siç thonë lart, bos. Një mbasdite vonë, kur unë isha vetëm në shtëpi, më vijnë dy vetë me maska dhe më rrëmbejnë. Nga ajo shtëpi ku më çuan, dëgjova të flisnin për një gjobë prej pesëdhjetë milionë. Nga ato pak që dëgjova, kuptova që do t'i çonin një pusullë, ku shkruhej që në filan datë e filan vend dhëndri të vendoste paret e kërkua, ndryshe ... Kaluan disa ditë dhe në vend të parave në vendin e caktuar kishin marrë një çantë të madhe dhe brenda vetëm një letër. Letrën ma lexuan mua. Dëgjo se çfarë na shkruan i poshtri: -Një, për të tre protezat e vjehrrës, kam paguar 5 000 lekë.

-Dy, për operacionin e

emoroideve, së bashku me pagesën e infermiereve dhe të doktorëve, 1000 000 lekë.

-Tre, për dy valvolat e zemrës që iu vendosën në Greqi, 10.000 000 lekë.

-Katër, për dy pasaporta falco, timen dhe të vjehrrës, 3 000 000 lekë.

-Pesë për shpenzimet e mia 15 ditë në Greqi, hotel, ngrënie pirje dhe buzuqe, 500 000 lekë, gjithësej 15 000 000 lekë.

Më sillni paret me çantën, që ju dërgova dhe mbani vjehrrën.

-Ja kjo është e gjitha dhe unë kam tre muaj që jam këtu.

Pertefi nuk pati kohë të shprehte atë indinjatë që po i ziente përbrenda nga sjellja e atij biçim dhëndri, sepse një dorë, që i kishin ngelur vetëm tre gishta, e tërhoqi pas vetes. -Ore, - filloi të flasë ai që e tërhoqi, - ti sot zbritë që lartë, kam parë dhe kam marrë vesh, çfarë bëhet atje me zgjedhjet?

Në zërin e tij ndihej një merak i madh.

-Lëre, - ia priti doktori- zien, zien, por ama qetësi, nga lart bije breshër premtimesh, premtime nga ato që nuk u plotësuan, premtime të tjera që do të bëhen, poshtë, në popull pro dhe kundër, por të gjitha pa dëm, vetëm llafe, unë gjithë natën shtrirë te dhoma e grave sa nuk plasa nga britmat që vinin nga dhoma e burrave.

"Ne e kemi bërë vendin lule, - thërriste njëri, - shiko se çfarë pasurie, ngado që të hedhesh sytë dyqane me vetrina të bukura dhe dënga plot e përplot. Kurse ju na i mbushët vendin me tezga e me kioska"

-"Ti nuk merr vesh fare." - ia kthente tjetri, ti je zero, je nul, po të mos hapeshin e të

bëheshin dyer të mëdha dritaret e kateve të para, po të mos dilnin në sheshe tezgat, po të mos ngriheshin doradorës kioskat, si do të lëvizte e do të rritej kapitali që të vinte më pas te minimarketet, merkatot e supermerkatot, te këta dyqane me vitrina kaq të bukura, kush do t'i sillte të gjitha këto përnjiherësh ti?! Ti që më dole nga ai regjim me brekët dyzet palë andrra?!

-Ja, këto biseda bëhen lart. Ka pastaj dhe probleme me listat e zgjedhjeve, ngatërresa sa të duash, për të votuar ti që je nga kjo lagje, do të shkosh të hedhësh votën në lagjen tjetër, ka prapë punë me të gjallë e të vdekur, disa të gjallë i kanë bërë të vdekur kurse disa të vdekur, i kanë ngjallur.

U ndje një si ofshamë e thellë dhe përpara këmbëve të Pertefit u rrokullis një diçka. Pertefi pa një kafkë me nofullat të çimentuara nga smërçi i kohës dhe dy gropat e thelluara të syve, ku u ndezën ca shkëndijime fosforike. Njëpërmjet disa brimave që kishin lënë disa nga dhëmbët e rënë, doli një si fëshkëllimë.

-Çfarë i ka ndodhur djalit tim, unë jam Kol Përnalla.

-Oh, jo, asgjë asgjë, - desh ta qetësonte Pertefi, - të kanë bërë të gjallë dhe ai kërkon të vendosë drejtësinë.

-Pa dale, - u hodh një tjetër, -

ka të tjerë?

-Ka, por se sa nuk e di, mund të jesh ti, ai, ai tjetri.

-Ç'është kjo hata, - u trazuan zëra të shqetësuar, - ky është kulmi!

-Të ngrihem në protestë dhe të kërkojmë ose të na heqin nga listat, ose në qoftë se na lënë të gjallë, të na paguajnë pensionin e munguar.

-Kjo të bëhet, të shkojë një përfaqësi, - ai i drejtoi gishtin njërit që ishte fare i plotë si skelet, - ti, ti je i gojës.

-Unë?! Në asnjë mënyrë, nuk jam i sigurtë për këtë, por kohët e fundit kam marrë vesh se shpërblimi i veteranit do të shkojë nga i jati te i biri, nga i biri te nipi dhe kështu brez mbas brezi deri te Skënderbeu.

-Po mirë çfarë lidhje ka kjo?

-Ka, si nuk ka, ore, njerëzit lart janë bërë veç të tjerave dhe smirëzinj. Ndërsa po më çonin për në varr, një shoku im i ngushtë që i kishte vënë shpatullat arkivolit i pëshpëriste tjetrit që kishte pranë: "Ore, unë me këtë kam qenë në një klasë, të dy të datëlindjes 1933, nga na doli veteran ky?"

Jo, unë nuk shkoj, kam frikë se do më prish punë

- Atëhere të zgjedhim një tjetër, - thirri një tjetër.

Pertefi ndjeu një dorë që ju mbështet në sup.

-Pertef, hajde me mua, le të merren me llafë ata.

Ka miliona e miliona vjet që të tjerë janë endur nëpër labirintet e kësaj humbëture dhe asnjë nuk ka mundur të gjej shtegun për t'u ngjitur lart. Hajde me mua të gjejë një vend të mirë ku t'i mbash në qetësi kockat.

Dhe Pertefi hodhi hapat e para drejt pafundësisë.

Vasil Kumani

## Përgjigje e fjalëkryqit

Ilirian Shori

	B	A	K	I	R	I		B	I	L	E	T	A		A
G	E	N	A	R	O		H	A	R	A	P	I		L	R
I	T	A	L	I		F	A	R	A	D	I		K	E	M
Z	I	N	A		L	E	V	A	N	I		G	O	T	E
E	N	I		M	A	R	A	Z	I		K	A	R	O	L
L	O		L	E	N	I	N	I		A	L	B	A	N	A
A		M	E	R	I	T	A		V	A	S	I	L	I	

Agim Mehqemeja

# Historiku i bibliotekave të Beratit

Fragmente



## BIBLIOTEKAT E KULTIT ISLAM

Në shekullin XVI në Berat fillon ndërtimi i objekteve të kultit: xhamitë dhe pranë tyre edhe medresetë. Deri në vitin 1670 ishin ndërtuar pesë medrese. Midis tyre, më të rëndësishmet, ishin medre-seja e Uzgurit dhe ajo e sulltan Bajazit Veliut, të ndërtuara pranë xhamive me të njëjtin emër. Në shekullin XVII u ndërtua pranë xhamisë së Hysen Pashës (Xhamisë së Sahatit), medreseja më e madhe e qytetit të Beratit. Kjo medrese u ndërtua nga Sali Beu dhe gruaja e tij Aishe Kadëna. Ajo kishte dhjetë dhoma fjetjeje dhe një sallë për mësim.

Asnjë prej medreseve të vjetra nuk është ruajtur. Deri vonë ka qenë vetëm medreseja pranë Xhamisë Mbret.

Biblioteka në Berat pati jo vetëm pranë medreseve, por edhe pranë teqeve. Përmendim bibliotekën e Teqesë së Helvetinjve, të Teqesë së Uzgurit si dhe të Teqesë së Rufainjve në lagjen Muratçelepi. 10)

Këto biblioteka patën një fond të pasur librash fetarë, filozofikë, historikë, shkencorë dhe artistikë. Ato kryenin funksion publik duke e vënë në përdorim të qytetarëve fondin e tyre të librave. Në mjediset e tyre zhvilloheshin disku-time midis dijetarëve dhe poetëve të kohës për probleme kulturore dhe letrare. Ato u bënë edhe vendgrumbullimi i veprave të krijuara nga autorë beratas.

Berati i shekujve XVII-XVIII u bë një qendër e rëndësishme kulturore, kryeqendra e letërsisë shqipe me alfabet arab.

Në Berat në këtë kohë njohim shumë autorë. Midis tyre përmendim poetët: Muçi Zade, Nezim Berati, Sulejman Naibi, Ismail Pashë Velabishti, Omer Sadedini, Mulla Aliu, Mehmet Ashkiu, Fejziu, Nabiu, Hikmetiu, Irziu, Sulejman Temani dhe shumë të tjerë.

Krijimtaria e tyre, divanet që ata krijuan, zunë vend



Medreseja, ku ka qenë një nga bibliotekat e pasura të kultit islam

në këto biblioteka, u kopjuan dhe u bënë pronë edhe e bibliotekave private.

Por fati i kësaj krijimtarië shumë të pasur ndoqi fatin e bibliotekave, atë të shkatërrimit, të humbjeve ose të grabitjeve. Ajo pak gjë që e kemi sot është mbetje e bibliotekave private.

Sali Durdia (1860-1930), në poezinë "Elegji për sheh Hasan Beratin", vdekur në vitin 1332 (1913), na kumton si një shenjë që ndoqi vdekjen e shehut, djegien e bibliotekës së Teqesë së Helvetinjve, ose, siç emërtohet ndryshe, e bibliotekës së Kurt Pashës, nga rebelët në vitin 1914:

**Shenja e kalimit të tij për në vendin  
e përjetësisë  
u shfaq me djegien e teqesë dhe të librave,  
që ndodhën në muajin e Ramazanit.**

Kjo bibliotekë ka patur shumë libra e

dorëshkrime në gjuhët e Lindjes: arabisht, persisht e turqisht, si dhe dokumente, që kishin vlera të veçanta për historinë dhe kulturën e qytetit dhe atë kombëtare. Një nga këto dokumente ishte edhe fermani (Hatti-Erman), i shkruar në një pllakë bakri, që u siguronte qytetarëve, si edhe korporatave, lirinë e punës, të ritit dhe të zakoneve të tyre. Këtu, gjendej edhe dorëshkrimi shqip i Nezim Beratis. 11)

## BIBLIOTEKA E SHKOLLËS SË KËSHTJELLËS

Në vitin 1778 u hap në Berat "Shkolla e kështjellës" në gjuhën greke.



Katedralja, ku ka qenë biblioteka e Shkollës së Kështjellës

Duke ndjekur shembullin e poetëve dhe dijetarëve beratas të fesë islame, edhe në këtë shkollë u bënë përpjekje të shkrimit të gjuhës shqipe me një alfabet të veçantë. Shkrimtari më i vjetër, që hartoi disa kronika shqip me alfabet këtë aalfabet, ka qenë Kostë Berati. Por kjo përpjekje nuk pati pasues të njohur dhe të peshës së autorëve të letërsisë shqipe me alfabet arab, letërsi që u bë pararendësja e letërsisë së Rilindjes Kombëtare.

Shkolla e Kalasë e vitit 1778 grumbulloi shumë libra dhe me to krijoi një bibliotekë në shërbim të nxënësve të shkollës. Kujdes për fondin e kësaj biblioteke tregoi mitropolit i Beratit Joasaf Gjeçi. Midis librave që hynë në fondin e kësaj biblioteke, ishte edhe vepra Pistis (Besimi), shtypur në venetik më 1773, me autor kallogjerin e Manastirit të Ardenicës Nektar Terpo. 12)

## BIBLIOTEKAT PRIVATE

Bibliotekat private kanë qenë ato që kanë plotësuar mungesën e bibliotekave publike. Ishin këto që krijuan mundësinë e qarkullimit të librit, të përhapjes së dijes, të ruajtjes së shumë dorëshkrimeve të vjetra.

Më të shquarat kanë qenë: biblioteka e Muzakajve, e Vrionasve dhe e Ismail Pashë Velabishtit.

Pas tyre mund të përmendim edhe shumë të tjera, më të vogla, që mbeten shprehje e dashurisë së beratasve për dije dhe kulturë.

Këto biblioteka janë shtuar dhe shumë, sidomos, pas vitit 1945, edhe pse në fondin e tyre bëri vend literatura politike dhe letërsia e realizmit socialist. Vetëm pas vitit 1990 këto biblioteka u pasuruan me literaturë të vërtetë, që më parë ishte një tabu e ndaluar.

Po u bëjmë vend në këtë historik vetëm atyre bibliotekave private, për të cilat kemi mundur të grumbullojmë informacion.

1. Në Velabisht, në vitet e sundimit të **Ismail Pashë Velabishtit** (1750-1764), u ngritën sarajet e pashait, ndërtesa e administratës, xhamia, teqeja dhe medreseja Ismail Pasha shkante me mendimin që ta zhvendoste qendrën e qytetit në Velabisht. Por ndeshi në rezistencën e parisë së Beratit. Zemërimi i pashait ra mbi protestuesit. Masakra u krye në

vitin 1757.

Pashai u pa për pak kohë me sy të keq nga sulltani dhe u dërgua si mbrojtës i kalasë së Lepantes në Greqi.

Dhimbjen për largimin me dhunë nga qyteti i tij e shprehu edhe në të vetmen poezi mbetur prej krijimtarisë së tij: "Mbi këtë kala të shkretë".

Ismail Pasha ishte njeri i librave. Ai krijoi në pallatin e tij një bibliotekë shumë të pasur me vepra në gjuhët arabe, perse dhe turke.

Me vrasjen e tij në vitin 1771, biblioteka iu grabit dhe iu dogj, sepse ishte deklaruar fermanli nga sulltani. Me bibliotekën e tij u dogj ose u grabit edhe krijimtaria e tij poetike. 13)

2. **Mehmet Nakshiu** (1830-1915) ka qenë njeri i ditur. Kishte një bibliotekë shumë të pasur. Dhomën e madhe të shtëpisë e kishte kthyer në një sallë ku lexohej dhe diskutohej për çështje të diturisë. 14)

3. **Sali Bisha** (vdekur në vitin 1917), ka kryer veprimtari arsimore e fetare. Edhe pse qe mistik, ai qe marrë me përhapjen e diturive jomistike. Në bibliotekën e tij, që i shërbente në punën e vet, la edhe një mexhmuaje (1853-1854), përmbledhje poezish, himnesh fetare, këshillash të së premtës, që ende nuk njihet. 15)

4. **Mehmet Esati** (1858-1942), mbaron arsimin e lartë për teologji e drejtësi në Kajro. Hap një medredrese pranë Xhamisë Mbret, ku afron shumë të rinj që u jep kulturën e tij. Qëndronte shumë mbi libra. Pranë tij, në dhomën e librave, qëndronin për t'u këshilluar e për të mësuar të moshuar e të rinj. 16)

5. **Sali Durdia** (1860-1930), ishte me kulturë. Zotëronte turqishten dhe persishten. Në bibliotekën e tij kishte edhe një përmbledhje me ilahi, që nuk është ruajtur. Ishte dhe poet. Prej tij kemi vetëm poezinë e gjatë "Elegji për vdekjen e sheh Hasan Beratis". 17)

7. **Islam Vrioni** (1865-1941), mbaron në Stamboll fakultetin e shkencave politike. Studioi arabishten, persishten, frëngjishten, greqishten e vjetër. Ishte njohës i thellë i filozofisë, arteve dhe letërsisë. Njhihte filozofinë e Sokratit, Platonit, Ibn Rushitit (Averoses), Farabiut, Kantit. Çmonte shkrimtarët persianë: Khajamin, Saadiun, Firdeusiun, Meulanane, Shirazinë. Zotëronte teorinë mistike, kishte dije mbi letrarët, sociologët e çdo shekulli. Çmonte dhe poetët beratas: Nezimin, Naibin, Omer Nadinin, por edhe De Radën, Naimin, Fishtën Ali Asllanin, Lasgush Poradecin. Këtë pasuri kulturore e gjeje edhe në bibliotekën e tij të pasur. Ka shkruar edhe prozë artistike dhe poezi. Kjo bibliotekë pas vdekjes së tij mbeti në dorën e të birit Memduh Vrioni. 18)

10. **Resulajt** kanë qenë një familje me tradita të hershme atdhetare e kulturore beratas. Kanë patur një bibliotekë të pasur me libra dhe dorëshkrime të vjetra. Mithat Frashëri ka dëshmuar se në bibliotekën e tyre ka parë një dorëshkrim me shkronja arabe, Divanin e Sulejman Naibit. Ky Divan ka qenë më pas në dorë edhe të Namik Resulit, studiues i njohur dhe hartues i një historie të letërsisë shqipe për shkollat e mesme në dy vëllime. Kjo bibliotekë ka patur dorëshkrimet dhe botimet edhe të Sulo Resulit (1874-1922).

10. Ferit Duka, "Berati në kohën osmane", Tiranë, 2001, faqe 192-195.

11. Agim Mehqemeja, "Poetë beratas në shekuj", Berat, 2000, faqe 105; Bardhyli, vepër e cituar, faqe 289; Zija Shkodra, "Esnafet shqiptare" (shek. XV-XX)", Tiranë, 1973, faqe 27.

12. Bardhyli, artikull i cituar, faqe 289.

13. Bardhyli, vepra e cituar, faqe 290; Qeramudin Durdia, Agim Mehqemeja, Bedri Telegrafi, "Hapësira të kulturës islame", Berat, 1999, faqe 31.14, 15, 19, 20 Qeramudin Durdia, Agim Mehqemeja, Bedri

Telegrafi, vepër e cituar, faqe 34 - 35.

# Mjedisi shqiptar është edhe mjedis evropian



Arian Soraj

**NDJESHMËRIA** ndaj mjedisit në Shqipëri është në nivele të ulta dhe sjellja jonë ndaj tij i ngjet sjelljes së virusit, që, pasi vendoset në një trup të shëndetshëm, e shkatërron atë dalë-ngadalë.

Objekti më i goditur i mjedisit tonë janë pyjet. Degradimi i tyre, krahas prerjes dhe zjarrit, ndihmohet edhe nga hedhjet e mbeturinave nga vizitorët e shumtë. Djegiet e këtij viti ndër pyje e kullota gjatë ditëve të nxehta të verës nuk përbënin lajm, për shkak të rutinës së tyre, por trishtues është fakti se për të shuar këto zjarre vrapojnë 4-5 punëtorët e pyjores, ndërsa banorët e tjerë qëndrojnë indiferentë dhe spektatorë si në një

ndeshje futboll.

Shkatërrimi i mjedisit tani përbën një front: pyjet, lumenjtë, kullotat, etj.

Një nga dukuritë më shqetësues është shfrytëzimi pa kriter i materialeve të tjera inerte, që përdoren për ndërtim. Në Qarkun e Beratit janë dy miniera për nxjerrjen e materialeve inerte: Ura

pa asnjë kriter i minierave të gurit dhe çakullit, që përdoren për ndërtime në krejt Shqipërinë e Jugut dhe atë të Mesme. Plagët e shkaktuara qëndrojnë si gojë të hapura në kodrat e bukura të kësaj zone.

E njëjta gjë po ndodh edhe në Malin e Tomorit, ku pelegrinazhi në malin e shenjtë, turizmi



Mali i Tomorit

Vajguore dhe Mali i Tomorit..

Kodrat nga Ura Vajguore deri në Veterrik janë shkatërruar nga shfrytëzimi i ethshëm dhe

malor, ka lënë pas mbetje që e kanë degraduar mjedisin. Nëse ngjitesh nëpër shtigjet shekullore të malit, vëren se ato nuk dallohen më. Do të



Lugina përgjatë lumit Osum

ndeshësh aty çadra plasmasi të improvizuara të punëtorëve që nxjerrin pllaka, lëkurë të deshëve dhe qingjave që përdoren për shtresë, ndesh edhe ndonjë çadër të madhe ushtarësh. E gjithë gjindja mbeturinat i hedh rreth e rrotull "fushimit".

Gjatë ditës punëtorët me kazma, leva, por edhe me eskavatorë, shpërndahen nëpër trupin e malit për të nxjerrë pllaka, jashtë çdo kriteri të shfrytëzimit të mjedisit,

jashtë çdo kriteri të parashikuar edhe në licencat e ministrisë përkatëse. Perla e turizmit malor, Mali i shenjtë i Tomorit po shfrytëzohet dita-ditës, si i gjithë mjedisi në Jug të Shqipërisë. Një pyll po digjet, nesër mund të ripërtërihet, ndërsa këto plagë në trupin e malit janë të pashërueshme. Shihni, nëse u bie rruga, mjedisin nga Bargullasi drejt Qafës së Sirakut për në Kulmak. Tani po tronditen edhe

burimet e Bogovës nga gërmimet. Shfrytëzimi me kriter të përcaktuara qartë, nga ndërmarrje që kanë licensë, kontrolli nga Ministria e Mjedisit, ndoshta do t'u shmange aksionin e madh të fshatarëve të zonës (shumica punojnë në të zezë, pa licensa, për shkatërrimin e mjedisit që është i tyre, që është yni, që është shqiptar, që është evropian.

Arian Soraj

P  
R  
E  
K  
N  
I  
P  
A  
S  
T  
Ë  
R  
T  
I  
N  
Ë

## Shpejtësi -Siguri-Pastërti

Pastrim  
kimik me  
pronar

Astrit Qafën



Nivel i  
lartë  
cilësor i  
pastrimit  
kimik  
të  
rrobave  
tuaja

Adresa: 20 m në krah të Postës në lagjen "Çlirim"

Tel: 069 20 85 220, 068 23 17 300

P  
A  
S  
T  
R  
I  
M  
K  
I  
M  
I  
K

# Fqinjëria e mirë

**POPULLI** ynë, shpesh, kur bie fjala për fqinjërinë, shprehet: "Fqinjët bëhen më të afërt se vëllezërit e motrat e tua". Fqinjët janë të gatshëm për natën e ditën, në raste hidhërimi e gëzimi".

Kisha më pak se një vit që isha i transferuar me punë në Berat. Banoja familjarisht në lagjen "Çlirim". Në vitin 1955 më vdiq nëna. Ende nuk isha njohur me fqinjët që më rrethonin. Menjëherë, kur morën vesh këtë ngjarje, jo vetëm që më erdhën për ngushëllim, por shoqëruan edhe arkivolin për në banesën e fundit. *A nuk është ky një akt humanitar i fqinjëve beratas?*

Fqinjërinë e mirë nuk duhet ta lidhim vetëm me pirjen e kafesë tek njëri-tjetri për të kaluar një pjesë të kohës, por edhe në raste të tjera që janë në shërbimin reciprok.

Në familjet qytetare që banojnë në pallate të privatizuara ka edhe pensionistë, të cilët dikur kanë ushtruar ndonjë profesion, p.sh. atë të mjekut. Ky mund të shkojë të fqinja fare mirë e ta ndihmojë brenda mundësive të sëmurin, ose të këshillohet edhe me mjekun e lagjes (që vjen vetëm kur e thërrasin familjarët...). Apo ndonjë arsimtar apo arsimtare, mund të ndihmojë ndonjë fëmijë të fqinjës së tij në ato lëndë që ai ka dhënë dhe që fëmija ka

nevojë. Ose fëmijët e rritur të fqinjës t'u marrin të moshuarve recetën apo barnat në farmaci...

Në fqinjërinë e mirë duhet të ndikojnë edhe dhëniet e ndihmave ekonomike, interesimi pranë organeve të Bashkisë për t'u dhënë ndihmat përkatëse. Të mos harrojmë të kaluarën: ishim ata që gjatë Luftës së Dytë Botërore u shpëtuan jetën ushtarëve italianë të braktisur apo dhe hebrenjve që ndiqeshin nga gjermanët. *Si të mos kujdesemi për fqinjët tanë që sot mund të jenë në kushte ekonomike të vështira?* Këto janë mënyrat më të mira që forcojnë dhe lidhin edhe më mirë fqinjërinë.

Në fqinjërinë e mirë ndikon edhe ruajtja e pasurisë së përbashkët.

Pjesa më e madhe e qytetarëve tanë banojnë në pallate, të cilët prej më se dhjetë vjetësh hyrjet e tyre i kanë privatizuar. Por edhe në shkallët e pallateve nuk ka munguar fqinjëria e mirë. Hyrjet në përgjithësi janë pronë e tyre private, ndërsa pallati, ku përfshihen këto hyrje është pasuri e përbashkët, siç janë shkallët, tarracat, muret, çatitë e shkallëve etj. dhe për mirëmbajtjen e tyre duhet të përgjigjen materialisht të gjitha familjet e shkallës. Pra, në pasurinë kolektive nuk

duhet të krijojmë të çara që çënojnë fqinjërinë e mirë.

Një fqinjë e sapoardhur me banim në katin e dytë, meqë e ka afër tarracën, na tha: "Tarraca është jona, e tri familjeve që banojmë në

mbajtur shpendët ... Për mirëmbajtjen e saj të gjithë jemi të angazhuar. Ne kemi mbi 40 vjet që banojmë në këtë pallat, duke ruajtur fqinjërinë e mirë e duke ruajtur edhe tarracën.



Dhomë karakteristike beratasë (muzeu etnografik)

katin e dytë, ju të katit të parë nuk keni punë me të. Sigurisht, me mirësjellje iu kthye përgjigjja, duke i thënë se tarraca nuk është as imja, as jotja, apo e ndonjë tjetri, por është e gjithë familjarëve që banojnë në këtë shkallë, sepse ajo na shërben të gjithëve. Iu bë e qartë se nuk është as fushë sporti për të lozur fëmijët, as për të mësuar biçikletat, as për të bërë ahengje, as për të

Sigurisht, fqinja që pretendonte pa të drejtë, e bëri menjëherë kthesën, hoqi dorë nga "uni" dhe hyri në gjirin e fqinjësisë.

Familjarët e mirë të pallateve duhet të merren edhe me edukimin jashtë-shkollor të fëmijëve. T'i këshillojmë fëmijët që të mos i ndryshojnë shkallët, të mos gërvishin apo të shkruajnë nëpër muret e jashtme, të mos lozin me top dhe të thyejnë

xhamat. I takon Bashkisë të merret, ose të mendojë, për krijimin e fushave sportive nëpër lagjet e qytetit.

Në fqinjërinë e mirë duhet pasur kujdes të veçantë mënjanimi i ndonjë grindjeje apo i ndonjë mërie, sepse mund të ndodhë kështu: familjes së katit të parë i pikon nga lartë dhe banja e saj i rri e lagët apo e ndotur. Kjo ndodh, sepse familjes së katit të dytë i është bllokuar banja. Atëherë këto dy familje duhet të merren vesh dhe familja e sipërme të marrë menjëherë masat për rregullimin e banjës së bllokuar, sepse lënia pas dore, jo vetëm që shkakton prishjen e higjienës, por prish edhe fqinjërinë e mirë. Këtu nuk kemi të bëjmë me një shpenzim kolektiv, por me një shpenzim vetjak të familjes.

Fqinjës nuk duhet t'i biem kurrë më qafë. Kur pyeta një

mikun tim se përse i keni zënë dritaret e dhomës, ai m'u përgjigj me keqardhje: "Fqinjës sonë iu krijuan mundësitë për të ndërtuar dhe një hyrje të dytë, ngjitur me pallatin tonë dhe, pikërisht me këtë ndërtim mbyllte edhe dy dritaret tona, duke na lënë kështu në errësirë. Fqinjës i thashë në formë shoqërore e miqësore, por ai nuk i mori parasysh kërkesat e familjes sonë. U detyrova të ankoem

në Bashkinë e qytetit, por fatkeqësisht kërkesa ime e drejtë nuk u dëgjua. U duk qartë se fqinja kishte përkrahjen e kryetarit të bashkisë, që, në kundërshtim me ligjin e kishte lejuar të ndërtonte shtëpinë dhe mua të më linte në errësirë".

Këto raste të hidhura e prishin fqinjërinë. Dhe shkaktarë të këtyre grindjeve bëhen qeveritarët bashkiakë, që, padyshim, lënë të nënkuptosh një veprim korrupsioni.

E përmenda këtë shembull, jo pa qëllim. Kryebashkiaku i ndersëm që do të zgjidhet së shpejti, t'i ketë në qendër të vëmendjes edhe ankimet e popullit dhe t'i zgjidhë ato me mendje të freskët e me duar të pastërta.

Për ecurinë e fqinjërisë së mirë jam i mendimit që në radhë të parë Bashkia duhet të krijojë një rregullore për administrimin e mirë të pasurisë kolektive të pallateve dhe për zbatimin e saj do të jetë mirë të krijohet një këshillë prej dy-tre vetësh nga vetë fqinjët, me mosha të reja (jo me pensionistë), që do të mundën të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve kolektive ose vetjake të pallatit ku jetojnë.

Me fqinjërinë e mirë plotësojmë detyra të dobishme shoqërore e humanitare, forcojmë kulturën tonë qytetare, ngrejmë lartë nivelin edukativ të qytetit.

**Fiqiri Tartari**

## Fabrika e prodhimit të bojërave dhe laqeve

### Alba-Color.Sh.p.k.

Bojërat më të mira me teknologji amerikane do t'i gjeni tek

Alba-Color.sh.p.k,

ku zbatohet sistemi i cilësisë ISO 9001. Tek ne do të gjeni një gamë të gjerë bojërash, plastike, akrilike, astarëve, bojëra vaji dhe zmalto dhe laqe të ndryshme, izolues tarracash, bojë rrugësh (traffik paint)

Adresa: Tek ish -uzina mekanike e tekstitit.

Tel-fax: 00355 32 33 922 Cel. 068 21 63 807 Cel. 068 23 73737



## “Tomori” - “Erzeni”: 4 - 1

“Tomori”, në takimin e luajtur në Berat, paraqitet krejt ndryshe nga takimi me “Erzenin”. Fitoi me lojë bindëse të konkretizuar me 4 gola. Fitorja e thellë ishte meritë e të gjithë futbollistëve dhe e aftësive të dy sulmuesve që shënuan Arbëri (3) dhe Mile. Arbëri me lojën e golat e tij më nxori mallin e kampionatit kur “Tomori” doli kampion. Vangjush

Milen, më të riun në ekip sportdashësit gjithmonë e shikojnë dhe e vlerësojnë me shpresë për të ardhme.

“Tomori” është në kuotën e 7 pikëve. Kryeson “Bylis” me 12 pikë dhe Laçi me 10 pikë.

Këtë javë “Tomori” do të luajë në Gjirokastrë.

## Fjalori art i tifozëve

JAVËN e kaluar dëgjova radioemisionin “Nga njëra ndeshje në tjetrën”. Në stadiumin e qytetit tonë luante “Lushnja” me “Besën”.

Gjatë lojës dëgjova në kor ulërime ofenduese të tifozëve në adresë të gjyqtarit: “O gjyqtar, o zagar!” Nuk di se të kujt qyteti ishin. Më vonë dëgjova edhe një tjetër “ansambël”, që ofendonte me një fjalor të art: “Gjyqtar të ... nënën”. Me sa kuptova këta të tjerët i

takonin jo vetëm qytetit të parë. Pra, të dy ekipet kishin modele tifozësh. Ndënja i qetë, pasi nuk ishin tifozë të “Tomorit”. Pastaj po mendoja: Po sikur ata të komisionit disiplinor të FShF të kenë dëgjuar dhe të dënojnë fushën tonë?! Ç’faj kemi ne. “Bukë s’hamë, thërrime bëjmë! Por përsëri qetësohem, pasi mendova do të dënohet “Besë”, mbasi “Lushnja” e dënuar është përderisa s’po luan në fushën e vet.

## Familja sportive Bushati

FAMILJA Bushati e ardhur nga Shkodra në Berat në vitet e para të çlirimit, është një familje sportive. Tre pjesëtarë të familjes kanë dhënë ndihmesë



Besa 1938, Viktor Bushati me top në dorë

në cilësinë sportive të ekipeve “Tomori”.

Viktori ka luajtur futboll me ekipet “Vllaznia” e “Besa” deri në vitin 1938, në vitin 1944 dhe 1945 ka luajtur me ekipin “Tomori” në rolin e



Robert Bushati

qendërmbrojtësit.

Roberti, i biri, ka luajtur basketboll me “Tomorin” dhe më vonë ka drejtuar ekipe të basketbollit për të rinj e fëmijë si edhe ekipin e të rinjve, i cili në kampionatet e viteve 1972-1973 është dalluar për rezultate të mira.

Valero fillimisht ka qenë basketbollist me ekipin me trajner me Konstandin Capo, pastaj me Ferdinand Starovën e Fatbardh Buzën. Më vonë trajner i ekipit të të rinjve



Valero Bushati me ekipin e fëmijëve

dhe fëmijëve. Për më shumë se dy dekada ka përgatitur breza basketbollistësh cilësorë me klasat sportive të shkollës “29 Nëntori”, ekipe këto që janë dalluar në veprimtari kombëtare.

## Shkruani mbiemrat e mundësive në vijat



1975, Ekipi i mundjes  
kampion, të rinj  
“Tomori”

---



---



---



---



---



---

Përgatiti faqen: Vlash Pambuku

Tek Syri do të gjeni lajmërimet për shitje dhe blerje të objekteve të ndryshme si: dyqane, shtëpi banimi, troje, makina, elektroshtëpiake, kanceleri, mjete transporti etj. etj.

Suplementi Syri është një rast i mirë për të gjithë ju që do të shitni, për të gjithë ju që do të blini.

Adresat e sakta, numrat e telefonit, kontaktet, çmimet jua ofron Syri i Lajmëtarit të Beratit. Ai është syri juaj për të kapur rastin e mirë, për të shitur dhe për të blerë.



Syri i  
lajmëtarit

Qytetarë të Beratit!  
Afrohuni pranë  
Syrit të gazetës  
dhe ai do të jetë  
Syri juaj.

## Njoftim

Syri i Lajmëtarit merr përsipër të publikojë kandidatë për kryetarë bashkishë dhe komunash, mesazhet e tyre drejtuar elektoratit, thirrje, jetëshkrime dhe programe të këtyre kandidatëve, qofshin partiakë apo të pavarur kundrejt një pagese. Syri i Lajmëtarit merr përsipër edhe sistemimin e ideve dhe mesazheve tuaja, kur e nevojitet.

Ejani te Syri i Lajmëtarit të Beratit syri juaj, syri i votuesve